






UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional
“Specialist Pajisjesh Elektronike”

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:



Grupi i vlerësimit të brendshëm ka përbërjen si më poshtë:

- | | | |
|-----------------------|--|---|
| 1. Dr. Luçiana TOTI | Kryetar (Lektore e Njesisë Bazë së Teknologjisë së Informacionit) |  |
| 2. Dr. Amarildo Rista | Anëtar (Lektor në Njësinë Bazë së Teknologjisë së Informacionit) |  |
| 3. MSc. Luan Sinanaj | Anëtar (Lektor në Njësinë Bazë së Teknologjisë së Informacionit) |  |
| 4. Spiro Paço | Anëtar (Koordinator institucional për akreditimin e programit i DKSC) |  |
| 5. Oriola Domi | Anëtare (Specialiste e DKSC) | |
| 6. Mirjet Shahinaj | Anëtar (Student) | |

Mars / 2023

Lista e shkurtimeve

RVB	Raporti i Vlerësimit të Brendshëm
UAMD	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
NJKTI	Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit
NJBTI	Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit
SPE	Specialist pajisjesh elektronike
DPMJ	Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë




PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Universiteti “Aleksander Moisiu” i Durrësit është Institucion i Lartë Arsimor Publik në Shqipëri, që ofron programin e studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”. Ky program studimi ofrohet nga Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit, pjesë përbërëse e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në UAMD (*Evidenca 1*_Mendimi i Dekanit).

Ky program ka si mision marrjen e njohurive të thelluara në fushën e aplikimit të pajisjeve elektronike për të krijuar specialist dhe kërkues të përgatitur në këtë fushë. Ata duhet të jenë në gjendje të transmetojnë informacione, ide, probleme dhe të sigurojnë zgjidhje për problematika të ndryshme në fushën e elektronikës. Ky program ka si qëllim të plotësojë nevojat e individëve dhe kompanive, që synojnë të ofrojnë shërbime në fushën e elektronikës ose kanë nevojë për shërbime në këtë fushë.

Studentët, që përfundojnë këtë program studimi, kanë mundësinë të punojnë si dizenjues i qarqeve të thjeshtë elektronike, riparues, mirëmbajtës dhe zbatues të pajisjeve elektronike (përfshirë pajisjet hardware); konsulentë për teknologjitë elektronike dhe multimediale me aplikime shumë të gjera në fusha të ndryshme: kryesisht në sistemet bankare, robotikë, mjekësi, komunikim, vizion kompjuterik etj. Aftësitë e përfituara u mundësojnë studentëve të jenë të aftë të nxiten të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike profesionale, për t’u ardhur në ndihmë kompanive apo institucioneve publike dhe private, që kërkojnë shërbime të ndryshme në fushën e elektronikës

Hapja e këtij program studimi është bërë me Urdhër Nr. 228, datë 10.07.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” (*Evidenca 2*_Urdhër i MASR për hapjen e programit), me kohë të plotë, me 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 2 (dy) vite akademike.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Përshkrim përmbledhës

Në vijim të procesit të aplikimit për akreditimin e programit profesional të studimit “Specialist pajisjesh elektronike” i ofruar në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Teknologjisë së Informacionit ngriti Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, bazuar në Urdhrin Nr.1, datë 20/01/2023 bashkëngjitur (*Evidenca 3_Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e RVB*) për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të programit profesional të studimit “Specialist pajisjesh elektronike”. Grupi i vlerësimit të brendshëm përbëhet nga 6 anëtarë, ku njëri është kryetar dhe 4 të tjerët janë anëtarë. Në grupin e vlerësimit të brendshëm, që operon si grup ‘ad hoc’, është përfshirë edhe një përfaqësues i biznesit në fushë e elektronikës dhe një përfaqësues i studentëve të programit të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”, i cili është në proces akreditimi. Çdo anëtar i grupit të vlerësimit të brendshëm është përzgjedhur bazuar në eksperiencën dhe njohuritë, që kanë në fushën e elektronikës.

Grupi i vlerësimit të brendshëm ka përbërjen si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|---|
| 7. Dr. Luçiana TOTI | Kryetar (<i>Lektore e Njesisë Bazë së Teknologjisë së Informacionit</i>) |
| 8. Dr. Amarildo Rista | Anëtar (<i>Lektor në Njesisë Bazë së Teknologjisë së Informacionit</i>) |
| 9. MSc. Luan Sinanaj | Anëtar (<i>Lektor në Njesisë Bazë së Teknologjisë së Informacionit</i>) |
| 10. Spiro Paço | Anëtar (<i>Koordinator institucional për akreditimin e programit i DKSC</i>) |
| 11. Oriola Domi | Anëtare (<i>Specialiste e DKSC</i>) |
| 12. Albios Lumani | Anëtar (<i>Student</i>) |

Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në

“Specialist Pajisjesh Elektronike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit “Specialist pajisjesh elektronike” si dhe programet e tjera të studimeve që ofrohen në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës janë programe që përputhen dhe mbështeten në interesat kombëtare dhe ndihmojnë në zhvillimin më tej të tyre. Ai është në përputhje të plotë me prioritetet kombëtare, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 si dhe me “Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026” ku i jepet prioritet programeve të studimit të fushës së IT dhe informatikës, programeve ndërdisiplnore dhe programeve. (<i>Evidenca 4</i> _Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026) Ky program studimi është në përputhje të plotë me ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit si pjesë e tij, në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program studimi ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) si dhe në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së Njësisë Kryesore të Teknologjisë së Informacionit dhe Njësisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit. Me misionin e tij Universiteti ka për qëllim nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësive dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin. (<i>Evidenca 5</i> _Statuti UAMD; <i>Evidenca 6</i> _Rregullore e UAMD, neni 3; <i>Evidenca 7</i> _Rregullore e NJKTI, neni 1)
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Qëllimi kryesor i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, bazuar në Planin Strategjik të UAMD 2020-2025, është hartimi i programeve në shërbim të individit, me qëllimin primar përsosmërinë e Universitetit dhe bërjen e tij sa më kompetitiv në tregun e punës. Këtë e mbështesim në kërkesat dhe interesin në rritje të studentëve për këtë program, numrit të studentëve të punësuar dhe të atyre që vazhdojnë më tej kualifikimin e tyre. Programi i studimit ofrohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UAMD, si dhe me drejtimit akademike të NJKTI ⁵ (<i>Evidenca 6</i> _Rregullore UAMD; <i>Evidenca 7</i> _Rregullore e NJKTI; <i>Evidenca 8</i> _Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025)
Kriteri 4. Programi i studimit	Programi profesional i studimit “Specialist pajisjesh elektronike”, që në

<p>hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>ideimin e tij, ka patur si synim të plotësojë nevojat e tregut të punës për specialistë teknik në fushën e elektronikës. Përgatitja e studentëve të aftë, siguron punësimin nëpër kompani apo institucione publike dhe private, që kërkojnë shërbime të ndryshme në fushën e elektronikës. <i>(Evidenca 9_Misioni dhe studimi i tregut të punës)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Në Njësinë Bazë të Teknologjisë së Informacionit zhvillojnë mësim 13 lektorë me kohë të plotë, të cilët janë të kualifikuar dhe kanë një eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës së tyre në universitetet publike shqiptare dhe në universite të huaja. Personeli akademik është "rritur" nga viti në vit, jo vetëm për të përballuar shtimin e numrit të studenteve, por edhe për të ngritur cilësinë dhe standartet e procesit mësimor. Në Njësinë kryesore të Teknologjisë së Informacionit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës zhvillojnë leksione një numër i vogël pedagogësh të jashtëm.</p> <p>NJKTI dhe NJBTI plotësojnë kriteret ligjore në lidhje me numrin e personelit akademik, si dhe të titujve/gradave shkencore. Vlen të theksohet se ky fakultet është hapur në vitin 2010 dhe ka krijuar tashmë një qendrushmëri akademike si në numrin e personelit akademik me tituj / grada shkencore por edhe në profilizimin e tyre në kurset përkatëse duke siguruar edhe një cilësi të lartë në mësimdhënie. <i>(Evidenca 10_Stafi akademik i NJKTI me gradat përkatëse)</i></p> <p>Personeli akademik i aktivizuar është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe me eksperiencë relativisht të gjatë akademike. Më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 84% e kurseve mbulohe nga personeli akademik i NJBTI - 4% e kurseve mbulohe nga personeli akademik i njësive të tjera bazë të NJKTI (NJB e Matematikës) - 12% e ngarkesës mbulohe nga personel akademik i njësive të tjera kryesore në UAMD 			
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit "Specialist pajisjesh elektronike" përmban kryesisht në kurrikula dhe kurse me karakter profesional. Fusha e studimit është në përputhje me fushën akademike të Njësisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit. <i>(Evidenca 11_Tabela e Klasifikimit / Kodifikimi UAMD)</i></p> <p>Stafi i Njësisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit është kryesisht i përbërë nga inxhinierë elektronik, telekomunikacioni, elektrik, etj., që mund të mbulojnë të gjitha kurset me karakter profesional dhe inxhinierik në fushën e elektronikës. Ky program studimi është shumë i nevojshëm në ditët tona për shkak të zgjerimit të sistemeve të integruara të teknologjive në të gjithë sektorët e jetës, shëndetit, ekonomisë, industrisë dhe edukimit në Shqipëri.</p> <p>Komuniteti Europian i ka përfshirë këto çështje dhe i mbështet ato në projekte të ndryshme ndërkombëtare me disponueshmëri të mjaftueshme të investimeve.</p> <p><i>"Ka akoma dallime të mëdha në nivelin e aftësive ndërmjet vendeve të BE-së dhe zbatimit të programeve për të zvogëluar ndarjen digjitale të Evropës", Andrus Ansip – Komiteti Evropian për Tregun Unik Dixhital – gjatë një fjalimi në Belgjikë, viti 2016..</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UAMD ka një strukturë institucionale të konsoliduar, ku çdo pozicion pune ka të mirë përcaktuara përshkrimet e punës dhe rregulloret për çdo departament apo sektor. Që në momentin fillestar të hapjes, UAMD ka patur frymë bashkëpunimi me qëllim që të plotësohej misioni i tij dhe të arriheshin objektivat e përcaktuara. Për këtë janë ngritur edhe zyra e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 12</i> Urdhër për ngritjen e NJSBC). NJKTI nxit stafin akademik, që të punojnë për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor për të qenë sa më bashkëkohore dhe në linjë me zhvillimin e fushës së elektronikës më gjerë. NJKTI harton orarin mësimor për programin profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” në koordinim me njësitë bazë të tij, ky orar i dërgohet njësisë bazë për të përcaktuar personelin akademik që do mbulojë kurset përkatëse. Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin me korrektësi të detyrave gjatë zhvillimit të mësimin në kursin që mbulon. Ndarjet e përgjegjësisë janë të mirëpërcaktuara në statutin e UAMD, në rregulloren e UAMD, si dhe në rregulloren e FTI.</p> <p>(<i>Evidenca 6</i> _ Rregullore UAMD, neni 3; <i>Evidenca 7</i> _ Rregullore e NJKTI, neni2, pika ç, ë)</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>UAMD ka mbi 53 marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja homologe në dy vitet e fundit dhe NJKTI po punon gjithnjë e më shumë në këtë drejtim për të rritur numrin e bashkëpunimeve në fusha specifike studimi. Aktualisht NJKTI bashkëpunon me disa universitete në kuadër të projekteve të Bashkimit Europian Erasmus+ duke bërë të mundur realizimin e shumë mobiliteteve për studentët dhe stafin akademik. Sigurisht që çdo veprimtari e marrë dhe çdo veprim i kryer brenda UAMD ka si qëllim përfundimtar të realizojë një rezultat pozitiv dhe një ecuri efektive.</p> <p>(<i>Evidenca 13</i> _ Marrëveshjet e UAMD me Institucione dhe biznese vendase për vitin 2021 dhe 2022, <i>Evidenca 14</i> _Lista e marrëveshjeve me Universitete brenda dhe jashtë vendit)</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve në UAMD përkujdeset të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi për të nxitur rritjen e marrëdhënieve me institucione homologe dhe biznese ku studentët mund të kryejnë praktikat profesionale dhe mobilitete. NJKTI ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere, me biznese të fushës si dhe ka aplikuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, që ofrojnë fonde për realizimin e objektivave të mësipërme. (<i>Evidenca 15</i> _Të dhëna mbi mobiliteteve të stafit akademik dhe studentëve).</p> <p>Këto marrëveshje përfshijnë edhe pjesën e praktikës mësimore dhe profesionale si në ambjentet e NJKTI ashtu edhe për praktikat profesionale pranë bizneseve partnere, investimet në infrastrukturë, trajnimin e studentëve dhe personelit akademik, shkëmbimin e studentëve dhe njohjen e krediteve</p>

	<p>për periudhat e shkëmbimit etj.</p> <p>Për shkak të natyrës së këtij programi studimi dhe të kurseve që përmban, praktikat mësimore zhvillohen kryesisht në ambjentet e NJKTI falë dhe investimeve në infrastrukturë që ky fakultet ka bërë për këtë qëllim.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Analiza dhe raportimi është një element shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e NjBTI. Në mënyrë periodike zhvillohen takime me përfaqësues biznesesh në funksion të realizimit të programit të studimit. Gjithashtu në përfundim të të marrëveshjeve hartohen raporte dhe plane për që lidhen me ecurinë e procesit të bashkëpunimit, si dhe për të kuptuar vlefshmërinë e rinovimit të tyre apo jo.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve zhvillohen aktivitete të ndryshme në dobi të tyre, si: workshop-e, konferenca studentore, ku studentët mund të paraqesin aftësitë e tyre profesionale para përfaqësuesve të sektorit public ose privat në lidhje me fushën e studimit.</p> <p>(Evidenca 16_Ftesa, axhenda dhe libri i abstrakteve e Workshop dhe Konferencës studentore)</p> <p>https://www.facebook.com/FTIUAMD/?locale=sq_AL (Workshop dhe konferenca studentore 2022)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

¹²Marreveshjet UAMD

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencorë në Republikën e Shqipërisë: "Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohet se njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë. Misioni i kësaj Drejtorie / NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. NjBSC është ngritur edhe në</p>
--	--

	<p>nivel fakulteti për NJKTI.</p> <p>(Evidenca 17_Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, neni 1, neni 8)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë i cili funksionon në bazë të elementëve të mëposhtëm. NjBSC-së kryen funksionet e mëposhtme:</p> <p>a) Mbështet dhe ofron ekspertizë. NjBSC kryen takime pune rregullisht me çdo fakultetet dhe çdo departament dhe ftohet nga ana e tyre, që të ofrojë ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, si dhe në asistimin e NjBSC në rang fakulteti. Ekspertiza duhet të përqendrohet rreth aplikimit të mekanizmave për sigurimin e cilësisë për të vlerësuar në mënyrë eksplicite procesin e mësimdhënies, të nxënit, si dhe metodave moderne të vlerësimit të studentëve, me qëllim promovimin e një qasjeje interaktive me në qendër studentin.</p> <p>b) Bashkërendon. NjBSC në nivel institucional, kur procesi i delegohet NjBSC-së pranë fakulteteve, kryen një rol bashkërendues dhe mund të shtrihet edhe në njësi të tjera në universitet kur NjBSC-ja konsiderohet e lidhur me funksione të tjera si zhvillimi i personelit dhe mbledhja/analiza e të dhënave institucionale.</p> <p>c) Interpreton detyrimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë. Ajo është përgjegjëse dhe ka për detyrë të interpretojë detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë dhe t'i përshtasë ato në kontekstin institucional të UAMD-së. NjBSC-ja garanton që këto detyrime të njihen dhe përfshihen nga IAL.</p> <p>d) Monitoron. NjBSC-së ofron udhëzime, mbledh informacione, evidenton probleme. Zgjidhjet e propozuara nga NjBSC-ja mbi problematikat e evidentuara, në varësi të nivelit të problemit, përmes Rektorit, mund t'i kalojnë për shqyrtim dhe miratim Senatit Akademik ose KPGSC-së.</p> <p>e) Administron dokumentacione. NjBSC-ja administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. Ajo përpunon pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele.</p> <p>f) Lehtëson: NjBSC-ja duhet të lehtësojë krijimin e një mjedisi të favorshëm me studentin në qendër, për arsimim cilësor dhe zhvillimin e stafit akademik për të përvetësuar njohuritë dhe teknologjitë e nevojshme për një proces me pjesëmarrje aktive gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>g) Siguron informacion për cilësinë tek aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të universitetit. NjBSC-ja siguron shpërndarjen e informacionit lidhur me treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në zbatim të legjisllacionit Shqiptar.</p> <p>Gjithashtu, në funksion të realizimit të funksionit të saj institucional NjBSC-ja duhet:</p> <p>a) Të hartojë dhe zbatojë një manual procedurash që përshkruajnë strukturën e institucionit dhe proceset për sigurimin e cilësisë; b) Të specifikojë kriteret për përzgjedhjen dhe formatet e treguesve, të standardeve dhe të objektivave;</p> <p>c) Të përgatisë formularët standardë për çështje të tilla si pyetësorët për studentët, administratën dhe stafin akademik, si dhe atyre alumni;</p>

	<p>d) Të këshillojë mbi procedurat operative për planifikimin dhe zbatimin e proceseve të cilësisë;</p> <p>e) Të mbledhë dhe të ruajë sistematikisht raportet mbi ecurinë, përfshirë të dhënat mbi treguesit dhe objektivat që do të kërkohen për analizën dhe raportimin e cilësisë së standardeve dhe kurrikulave.</p> <p>(Evidenca 17_Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, neni 9)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat shprehen qartësisht në pjesën gjashtë të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë UAMD ju nënshtrua në vitin 2022 procesit të Akreditimit Institucional dhe u vlerësua me një Akreditim për 4 vite akademike (VBA Nr.18, datë 24.03.2022; 24/03/2022 deri në 23/03/2026)</p> <p>(Evidenca 17_Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, neni 17-19)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>UAMD përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Të dhënat statistikore:</p> <p>NjBSC-ja përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjBSC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve. Të dhënat kryesore statistikore përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit; • mundësitë e punësimit të të diplomuarve; • profilin e popullatës studentore; • raportin pedagog/studentë; • plotësimi i kërkesave të studentëve me programet e tyre; • efektivitetin e pedagogëve; • koston e burimeve të mësimnxënies dhe disponueshmërinë e tyre; • monitorimin e situatës së punësimit të të diplomuarve; • nivelin e largimit/transferimit të studentëve ; • numrin i stafit dhe studentëve që pranohen dhe largohen; • treguesit kyç të performancës së institucionit dhe elementë të ngjashëm. <p>NjBSC-ja bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të institucionit për të dhënat statistikore, që do të parashikonte një analizë sistematike të këtyre treguesve. Strukturat e ndryshme të SBSC-së kryejnë mbledhjen e të dhënave, në varësi të llojit të informacionit të kërkuar dhe analiza përcillet në NjBSC. Të dhënat mund të përfshijnë sa më</p>

Arton

Hq

Arton

Arton

Arton

	poshtë: <ul style="list-style-type: none"> Ndjekja e të diplomuarve për të gjitha programet dhe nivelet nëpërmjet studimeve vjetore për të analizuar kohën që u duhej studentëve të gjenin një punë dhe në cilin nivel, pagat e tyre, sa të kënaqur janë në punën dhe arsimin e tyre etj. Këto të dhëna analizohen për të nxjerrë një listë të të punësuarve, me qëllim për të ndihmuar studentët aktualë të planifikojnë të ardhmen e tyre profesionale. Kjo qasje lejon analizimin e përshtatshmërisë së ofertës arsimore me mundësitë e punësimit të të diplomuarve; Vlerësimet vjetore të studentëve në bazë programi dhe niveli studimi; Mbledhja e të dhënave vjetore të të gjitha programeve të studimit mbi bazën e një grupi treguesish; Analiza e të dhënave sociale dhe financiare duke përfshirë por pa u limituar tek grantet studentore dhe strehimi. (<i>Evidenca 17_ Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, neni 15</i>) 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi

Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të	Programi profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” ofrohet si program me kohë të plotë me 120 kredite (ECTS) me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Mbështetur në dispozitat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë, ndarja e lëndëve në kurrikul është organizuar duke u bazuar në VKM nr.41, datë 24.01.2018 për “Elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Plani mësimor përcakton qartë të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e
---	--

<p>Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>programit profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Në planin mësimor është përcaktuar ndarja e krediteve midis kurseve dhe semestrave, ndarja e veprimtarive formuese dhe peshat e tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndarja e ngarkesës së orëve mësimore në auditor dhe ngarkesa e studimit. Gjithashtu caktohet edhe ngarkesa e provimit përfundimtar të diplomimit (6 kredite) dhe që është parashikuar që të jetë 100% studim individual nga ana e studentit.</p> <p>Ndarja e peshës së kategorive për veprimtaritë formuese është në përputhje me kërkesat ligjore për programet profesionale të, përkatësisht:</p> <p>A - Lëndë Bazë - 15%</p> <p>B - Lëndë Karakterizuese - 50%</p> <p>C - Lëndë Ndërdisciplinore - 20%</p> <p>D - Lëndë Plotësuese - 10%</p> <p>E - Detyrime Përmblyëse - 5%</p> <p>Për të kompletuar elementët që përbëjnë strukturën e programit profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike”, në dokumentacionin shoqërues gjeni edhe programin lëndor dhe formatin e miratuar të diplomës dhe suplementit.</p> <p><i>(Evidenca 18_ Plani mësimor i programit të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Të gjitha programet e studimit profesional, që ofron Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit kanë si synim të informojmë dhe përgatisim specialist të aftë për tregun e punës. Programi profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” ka për qëllim që t’u japë studentëve njohuri specifike teknike, t’i njohë ata me teknologjitë më të fundit të pajisjeve elektronike si dhe t’u japë njohuri mbi trendet e zhvillimit dhe aplikimit të tyre. I gjithë programi është ndërtuar bazuar në analizën e nevojave të tregut të punës, sugjerimet dhe rekomandimet e partnerëve europianë në këtë fushë dhe atyre të marra nga stafi akademik që është pjesë e këtij programi.</p> <p>Programet e studimit profesional zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha profesionale. Këto programe studimi hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me qëllimin që të formojnë studentët të aftë nga ana praktike.</p> <p><i>(Evidenca 9_ Misioni dhe studimi i tregut të punës dhe mundësi punësimi)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi “Specialiste pajisjesh elektronike” ka si synim dhe objektiva kryesor të përgatisë specialistë me njohuri teorike dhe aftësi praktike për të konkuruar në tregun e punës²⁴. Kurrikula e këtij program studimi në përbërje të saj përfshin kurse specifike të bazuara vetëm në projekte praktike të realizuara nga studentët. Në hapjen e këtij program studimi është bërë një studim paraprak i tregut të punës në fushën e elektronikës në Shqipëri²⁵.</p> <p>Në hartimin e kurrikulës janë marrë parasysh njohuritë teorike dhe praktike, aftësitë dhe kompetencat që duhet të zotërojë një specialist i pajisjeve elektronike, i cili duhet të ofrojë shërbime teknike dhe këshilluese profesionale në fushën e elektronikës.</p> <p><i>(Evidenca 19_ Shtojca Nr. 2, Objektivat kryesore formuese të programit dy-vjeçar të studimit “Specialist pajisjesh elektronike”)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të</p>	<p>Programi profesional i studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” ka në total</p>

<p>përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>120 kredite ECTS dhe ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët, duke përfshirë kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Bazuar në Planin Mësimor të programit të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”, çdo lëndë është përcaktuar të ketë 6 ECTS dhe lëndët janë të ndara në dy semestra, ku çdo semestër përmban 30 ECTS. Në total programi i studimit ka 23 lëndë, si dhe provimin përfundimtar të diplomimit (<i>Evidenca 18_</i> Plani mësimor i programit të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”; <i>Evidenca 20_</i> Suplementi i diplomës; <i>Evidenca 21_</i> Syllabuset e lëndëve).</p> <p>Në secilen prej kurseve studenti është i detyruar të zhvillojë një punë e pavarur praktike apo një detyrë me karakter praktik, detyrim i cili vlerësohet me 10% të vlerësimit total. Aftësimi profesional nëpërmjet praktikave profesionale nuk është i integruar në planin mësimor, por i ofrojmë studentëve praktika profesionale nëpërmjet marrëveshjeve të bashkepunimit ndërmjet UAMD dhe sektorit të biznesit brenda orëve me karakter praktik në çdo lëndë.</p>			
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve dhe pranimi i studentëve është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80 / 2015, neni 69. Politika e mbështetjes financiare për studentët azuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave.</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi profesional i studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” është i vetmi program i ofruar në IAL publike, por nga studimi i bërë paraprakisht për ofrimin e tij pranë NJKTI kurrikulat janë mbi 70% i ngjashëm në përmbajtje me programe të tilla në nivel rajoni e më gjerë.</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. (<i>Evidenca 11_</i> Tabela e klasifikimit / kodifikimit të programeve të UAMD).</p> <p>Ky program i përket kodit: S52PP0619</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.2</p> <p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit</p>	<p>Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit bazuar në legjislacionin në</p>

<p>përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislaconin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>fuqi është e organizuar në 3 (tre) Njësi Bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njësia Bazë e Shkencave Kompjuterike 2. Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit 3. Njësia Bazë e Matematikës <p>Të tre këto njësi bazë veprojnë me mision dhe vizion të qartë.</p> <p>NJKTI dhe Njësitë Bazë, përgjegjëse për programet e studimit përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike dhe njohin përgjegjësitë e tyre, në mënyrë që të rrisin procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit është e përbërë nga 13 anëtarë efektiv si staf akademik, njëri prej të cilëve ka gradën shkencore “Profesor i Asociuar”. 6 lektorë kanë gradën shkencore “Doktor” dhe lektorë të tjerë janë në proces për marrjen e gradës shkencore “Doctor”. Njësia Bazë e Shkencave Kompjuterike është e përbërë nga 18 anëtarë efektiv si staf akademik, 4 prej të cilëve kanë gradën shkencore “Doktor”. Njësia Bazë e Matematikës është e përbërë nga 17 anëtarë efektiv si staf akademik, 12 prej të cilëve kanë gradën shkencore “Doktor/Docent”.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislaconin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Në strukturën e NJKTI aktualisht janë pesë personel ndihmës akademik ku secili prej tyre është përgjegjës për mirëmbajtjen e një laboratorit të caktuar.</p> <p><i>(Evidenca 35_CV e stafit ndihmës akademik për programin profesional SPE)</i></p> <p>Ky personel ndihmës akademik ka përfunduar studimet në profilet e shkencave kompjuterike, multimedias dhe televizionit dixhital, teknologjisë së informacionit dhe kanë kualifikimin e duhur dhe aftësitë për të mbuluar detyrimet e tyre për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe ofrimin e mbështetjes për personelin akademik për zhvillimin e orëve mësimore apo orëve praktikave në këto laboratore.</p> <p>Gjithashtu pjesë e FTI është edhe personeli administrativ në ndihmë të programit mësimor si pjesë e sekretarisë mësimore, ku një prej tyre është e dedikuar për programin profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike”</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Mbështetur edhe në rregulloren e UAMD, personi i caktuar si koordinor i programit profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është Dr. Luçiana Toti. Koordinimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me përgjegjësën e NJBTI dhe zv. Dekanin për anën mësimore.</p> <p>Koordinatori i këtij programi studimi ka qënë pjesë e grupit të punës për hartimin e kurrikulës. Ai ndjek ecurinë e studentëve dhe trajton problematikat e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve të tyre.</p> <p>Koordinatori i programit profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” informon në mënyrë të vazhdueshme drejtuesin e njësisë kryesore / bazë në lidhje me ecurinë e programit të studimit si dhe është një nga personat e kontaktit për studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Evidenca 22_ Vendimi për përcaktimin e koordinorëve të programeve të studimit)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	NjKTI dhe NjBTI përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional në SPE, disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit (syllabuse të kurseve të ofruara, rregullore programi, vendime të njësisë bazë). Urdhërat dhe vendimet për hapjen e këtij programi janë të ruajtura në protokollin e NJKTI sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi ³² si dhe zotërohen edhe nga NjBTI së bashku me dosjen e plotë të programit të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”. (Evidenca 23_ Rregullore mësimore për programin profesional SPE)
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit shtrihet në dy vite akademike me 120 kredite ECTS. Lëndët janë të ndara në katër semestra, ku çdo semestër përmban 30 ECTS. Cdo semestër ka 15 javë mësimore në auditor, pra 45 orë mësimore për cdo lëndë në auditor (3 orë në auditor çdo javë/lëndë). Bazuar në Planin Mësimor të programit të studimit SPE, çdo lëndë është përcaktuar të ketë 6 ECTS dhe Në total programi i studimit ka 23 lëndë dhe provimin përfundimtar. Plani mësimor i programit të studimit profesional në SPE, përfshin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor / jashtë auditorit, frekuentimin /ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. (Evidenca 18_ Plani mësimor për programin profesional SPE)
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Studentët që ndjekin programin e studimit SPE informohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me të gjithë elementët e përfshirë në procesin e mësimit. Në website të UAMD dhe rrjete sociale studentët informohen mbi evente të ndryshme në lidhje me jetën studentore dhe me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit. Ndërsa për sa i përket kurrikulës ata mund të informohen nga stafi akademik, nëpërmjet broshurave. Për informacione në lidhje me orarin e mësimit, transferimit, ekuivalentimit të studimeve dhe provimet, studentët mund të marrin informacion të detajuar pranë sekretarisë dhe kryesekretares. (Evidenca 24_Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve; Evidenca 25_Vendim Senati për Kuotat)
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat,	Plani Mësimor përmban informacionet e nevojshme për lëndët, për orët që student kalon në auditor dhe orët e punës së pavarur jashtë auditorit. Për sa i përket syllabuseve, studentët informohen nga lektorët e lëndëve përkatëse mbi objektivat dhe qëllimet, temat dhe

<p>seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>mënyra e vlerësimit.</p> <p>Frekuentimi dhe mënyra e vlerësimit të studentëve është e unifikuar për të gjithë kurset. Frakuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75%.</p> <p><i>(Evidenca 6_ Rregullore UAMD, neni 66)</i></p> <p>Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem pikëzimi prej 1000 pikësh, i cili konvertohet me notë në proces-verbalin përfundimtar ku nota kaluese më e ulët është nota pesë e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara. Vlerësimi bëhet përgjatë semestrit dhe bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) 2. Provimi përfundimtar (50%) 3. Projektet / detyrat e kursit (10%) <p><i>(Evidenca 21_ Syllabuset e lëndëve), Evidenca 26_Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e sistemit të vlerësimit të studentëve)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Cdo vit të ri akademik Përgjegjësi i Njësisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit angazhon koordinatorët e programeve të studimit të mbledhin syllabuset e përditësuara me tema dhe literatura të reja bashkëkohore për shkak të zhvillimeve të shpejta teknologjike. Këto përmirësime nuk i kalojnë 20% të ndryshimeve të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë.</p> <p><i>(Evidenca 17- Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë NjBSC)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi II.4</p> <p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Specialist Paisjesh Elektronike” është një program i ri studimi.. Lendet e këtij programi janë të përzgjedhura me kujdes duke u bazuar në kurrikulat e Universiteteve Ndërkombëtare, të cilët janë ekspertë në këtë fushë, si dhe në nevojat e tregut të punës në vendin tonë. Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit, qëllimet dhe njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor kanë në fokus aftësimin e studentëve nga ana praktike. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit është hartuar duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë dhe bazuar specifikisht në:</p> <p>1) Ligjin Nr. 80/2015, datë 25.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe</p>

	<p>kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;</p> <p>2) VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”;</p> <p>Ky program studimi ka objektiv të aftësojë studentët mbi zhvillimin e produkteve elektronike, mirëmbajtjen e riparimin e tyre, të aftësojë studentët në marrjen e vendimeve teknike të duhura në pajisjet e bizneseve dhe të përshtaten me kushtet e ndryshimit të teknologjive, të kombinojë njohuritë teorike dhe praktike të fushës së elektronikës për të realizuar detyra të ndryshme sipas kërkesave të bizneseve, sigurimin punësimeve të studentëve me bizneset partnere brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>(Evidenca 9_Misioni dhe studimi i tregut të punës)</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Plani Mësimor përshtatet me kuadrin ligjor në fuqi dhe përmban informacionet e nevojshme për lëndët dhe natyrën e tyre, për orët që student kalon në auditor dhe orët e punës së pavarur jashtë auditorit, pra gjithëcka në funksion të arritjes së objektivave formues të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrajt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimi në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Lëndët e vitit të parë ofrojnë përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme, lëndë plotësuese si dhe lëndët bazë karakterizuese si “Sisteme Informacioni”, “Bazat e elektroteknikës”, etj. Objektiv i vitit të parë është të mundësojë që studenti të integrohet gradualisht me ambjentin universitar, metodologjinë e mësimdhënies, etj. Gjatë vitit të dytë studenti ndjek lëndë karakterizuese profesionale për të përfutur bazat e nevojshme teorike edhe praktike për formimin e tyre profesional. Objektiv i lëndëve të vitit të dytë është që ti ofroj studentëve njohuritë karakterizuese e nevojshme profesionale e nderdisiplinore.</p> <p>Mbi 25% e programit ka lëndë karakterizuese dhe nderdisiplinore, që i dedikohen aftësimi praktik, si: Administrim dhe konfigurim serverash, Matje elektrike dhe elektronike, Riparim pajisjesh elektronike, Rrjete kompjuterike, Sisteme shfrytëzimi, si dhe lende nderdisiplinore, si: Montimi i kompjuterit personal, diagnostifikimi i problemeve në logjistikë, qarqe kontrolli, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit “<i>Specialist Pajisjesh Elektronike</i>”, studentët mund të punësohen në sektorin privat dhe publik si teknik elektronik, specialist të pajisjeve të elektronikës, fabrikues prototipi dhe më shumë për kompanitë që specializohen në dizajnimin e thjeshtë elektronik, prodhimin, shërbimin dhe zhvillimin e qarqeve elektronike etj.</p> <p>Ky program studimi është ndërtuar që të krijojë mundësinë e ndjekjes së studimeve në degë të tjera të ngjashme (teknik elektrik, specialist të sistemeve të kondicionimit, etj) të ofruara në UAMD ose në Shkollën Profesionale apo kolegje jashtë UAMD dhe siguron krahasueshmërinë e kurseve të ndryshme përmes përdorimit të krediteve (ECTS) dhe krediteve në sistemin amerikan (USCr).³⁶ Kjo u jep mundësi studentëve të mund të ndjekin studimet apo transferohen nga një universitet tek tjetri brenda dhe jashtë vendit.³⁷</p> <p><i>(Evidenca 27_Për miratimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit të UAMD), Evidenca 7_Rregullore e NJBTI, neni 38, 42)</i></p>

<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Programi i studimit profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” është në vitet e para të implementimit dhe të gjitha syllabuset e lëndëve/moduleve që ofrohen janë përgatitur bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur cikle leksionesh për çdo lëndë specifike. Studentëve u ofrohen libra të vendit dhe të huaj, të cilët janë prezent në bibliotekën e universitetit.</p> <p><i>(Evidenca 8_Plani i zhvillimit strategjik u UAMD, 2020-2025; Evidenca 17-Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë NjBSC; Evidenca 28_VKM: Për elementet e programit të studimit të ofruara nga IAL)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Kurrikula e pasur me karakter profesional dhe me objekt studimin e teknologjive bashkëkohore, lehtëson arritjen profesionale të studenteve në fund të programit të studimit. Gjithashtu, garanton formim të kosiderueshëm praktik në përputhje me kërkesat e punëdhënëseve për inteshipe dhe punësim.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Programi profesional “Specialist Pajisjesh Elektronike” bën të mundur që studentët të fitojnë njohuritë e duhura për të përballuar sfidat e tregut të punës në fushën e elektronikës dhe do të përgatiten nga ana profesionale për të vazhduar progresin në fushën e kualifikimit më të avancuar profesional. Programi ofron një sfond të gjerë të bazuar në nevojat dhe trendet aktuale në industrinë e elektronikës. Lektorët e angazhuar në këtë fushë janë përzgjedhur me përvojë shumëvjeçare me qëllim përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për studentët e këtij programi studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi II.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë</p>	<p>NJKTI dhe NJBTI në bashkëpunim me institucionet që kemi marrëveshje, kanë realizuar takime, ku janë dhënë udhëzime lidhur me përmirësimin e programit mësimor dhe teknologjitë më të fundit në fushën e pajisjeve elektronike. Këto sygjerime do të merren në konsideratë në vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>(Evidenca 17- Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë NjBSC)</i></p>

nga tregu i punës.									
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	UAMD organizon pyetësorë në formë elektronike dhe fizike nëpërmjet Degës së Kurrikulës dhe Cilësisë për të marrë mendimin e studentëve në lidhje me procesin e mësimin si kurrikula, lëndët dhe metodat e mësimdhënies. UAMD ka një degë specifike për monitorimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të punësimit të të diplomuarve të tij nëpërmjet Degës së Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit. Gjithsesi ky është njëprogram i ri studimi dhe po krijon kontakte me specialist të fushës dhe në të ardhmen me studentë e diplomuar. (Evidenca 47_Baza e të dhënave mbi punësimin e studentëve të NJKTI)								
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	Gjatë implementimit të programit profesional të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” (që nga hapja e tij), nevojat e tregut të punës në këtë fushë janë rritur dhe për pasojë të zhvillimit dhe modernizimit të teknologjive të pajisjeve elektronike, ndaj stafi akademik përpiqet të strukturojë dhe përditësojë syllabust brenda programit të studimit sipas kërkesave dhe nevojave të tregut të punës. Në përfundim të cdo viti akademik, stafi bën analizën e punës dhe vë theksin në përmirësimin e programit të studimit nëpërmjet përmirësimit të syllabuseve, përmirësimit të infrastrukturës dhe plotësimit me bazë materiale në shërbim të aftësisimit praktik të studentëve, lidhjen e marrëveshjeve të reja, etj. Këto ndryshime reflektohen pasi miratohen nga organet drejtuese përgjegjëse në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat	UAMD praktikon një formë interaktive dhe inovatore të gërshimit të orëve të leksionit me seminarin, që nxit debatin pedagog – student. Format kryesore të procesit mësimor janë leksionet e integruara me shembuj praktikë dhe projektet e realizuara nga studentët. Lektorët për të siguruar mësimdhënie cilësore përdorin metoda bashkëkohore

<p>profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>bazuar në eksperiencën e universiteve homologe të vendeve të zhvilluara të BE. Prezantimet e materialeve mësimore bëhen me kompjuter/laptop dhe projektor, ku paraqiten jo vetëm leksionet në powerpoint, por edhe me video apo ilustrime të tjera sipas nevojës. Studenti është në qendër të vëmendjes dhe orët e mësimimit në janë interaktive duke u realizuar edhe në formën e diskutimit.</p> <p>Në UAMD çdo lëndë mësimore zhvillohet ose organizohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • orë leksionesh; • orë seminaresh; • orë të integruara të leksioneve me seminarët; • projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup • provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; • në formën e praktikës profesionale të zhvilluar në laboratore të NJKTI-së, dhe/ose në institucione dhe kompani me të cilat NJKTI / UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi <p><i>(Evidenca 13_Lista e marrëveshjeve)</i></p> <p>Orët mësimore zhvillohen në mënyrë të pandashme në leksione dhe seminare. Leksionet e hapura parashikohen në planifikimin e aktiviteteve të vitit akademik dhe miratohen nga njëسيا bazë.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mesimnxënies.</p>	<p>Ky program studimi është hapur para dy vitesh akademike dhe çdo lektor i angazhuar në mësimdhënie është përpjekje të sjellë metodat më bashkëkohore si në mësimdhënie ashtu edhe në njohuritë teorike dhe praktike. Staf i akademik është mjaft bashkëpunues me studentët dhe të gatshëm të reflektojnë syzjerimet e studentëve të bazuara në eksperiencat e tyre personale. <i>(Evidenca 29_Kodi i etikës, neni 4)</i></p> <p>Permirësimi i bazes laboratorike ne Fakultetin e Teknologjise se Informacionit, perdorimi i videoprojektorëve, smartboardit, disponibiliteti i internetit, nxitja e metodave interaktive, etj. janë menyra alternative te mesimdhënies e mesimnxënies.</p> <p>Një prej mënyrave të komunikimit është nëpërmjet Google Site ku çdo pedagog i Unversitetit krijon një faqe dinamike me mundësi për të komunikuar me studentët për aspekte të ndryshme të procesit mësimor kërkimor.</p> <p>Bibliotekë online ku stafi akademik mund të aksesojë publikime të ndryshme në përshtatje me nevojat e studentëve (https://ulibrary.rash.al)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Institucioni ngre politika të vlerësimit akademik dhe mbështet stafin e angazhuar në mësimdhënie. Rëndësi të vecantë i kushtohet nevojës, që mund të ketë stafi akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e kurrikulës dhe trajnimeve ne drejtim te permirësimit te praktikave të mësimdhënies.</p> <p>Në fillim të çdo semestri gjatë vitit akademik bëhet një kërkesë nga Drejtuesi i Njësisë Bazë drejtuar Zyrës së Financës me qëllim që të mbulohem nevojat për mjete didaktike dhe kancelari për lektorët. Kryesisht për mjete didaktike kërkohen projektorë dhe kompjutera në auditore.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe</p>	<p>Në programin e studimit “Specialist Paisjesh Elektronike” janë angazhuar lektorët të cilët janë me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe me njohuritë e duhura në fushën e eletronikes.</p>

Arson

189

[Signature]

[Signature]

<p>koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>(Evidenca 35_CV stafi akademik i NJBTI)</p> <p>Çdo lektor gëzon liri akademike për të organizuar mënyrën e mësimdhënies konform tematikës së trajtuar dhe përdor teknologji të ndryshme që i vijnë në ndihmë mësimdhënies si prezantime, video dhe demonstrime praktike. Përdorimi i këtyre metodave e bëjnë edhe më interaktive orën e mësimin.</p> <p>Lektorët nxitin diskutime mbi probleme të ndryshme teknike dhe kërkojnë mendimin e studentëve për zgjidhjen e tyre, duke respektuar ato dhe duke ofruar zgjidhjen më të efektshme nga ana profesionale.</p> <p>Ata kanë mundësi komunikimi dhe të shprehin mendimet e tyre jo vetëm me lektorë, por edhe me drejtuesit e Njesisë Bazë dhe Njesisë Kryesore.</p> <p>(Evidenca 29_Kodi i etikës)</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Drejtorja e Kurrikulave dhe Cilësisë monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike performancën e stafit akademik nëpërmjet formularëve dhe pyetësorëve, konkretisht si: Formulari i vetvlerësimit nga lektorët, formulari i kërkimit shkencor, rikontrolli i provimeve për vitin akademik, vlerësimi i studentëve dhe monitorimi i prezencës së stafit gjatë mësimdhënies.</p> <p>(Evidenca 45_Analiza e pyetësorëve)</p> <p>Rezultatet e pyetësorëve skanohen me anë të lexuesit optik, përpunohen dhe ju bëhen të njohura njësive kryesore dhe njësive bazë përkatëse. Çdo lektor me kohë të plotë dhe me kohë të pjesëshme që janë të angazhuar në çdo semester në mësimdhënie informohen me email për rezultatet e vlerësimit nga pyetësorët e studentëve duke ruajtur privatësinë e informacionit.</p> <p>(Evidenca 17- Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë NjbSC, Evidenca 30_Rregullore e Drejtorisë së Projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë)</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e</p>	<p>UAMD dhe çdo njësi kryesore e saj funksionon bazuar në Rregulloren dhe Statutin, të hartuara dhe miratuara në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë. Gjithashtu në çdo syllabus të lëndëve janë të shpjeguara mënyrat dhe elementet e vlerësimit të studentëve.</p>

<p>programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Vlerësimi bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) 2. Provimi përfundimtar (50%) 3. Projektet / detyrat e kursit (10%) <p>Ndër detyrat e sekretarisë mësimore të NjKTI dhe Kryesekretares është arkivimi dhe ruajtja e dokumentacionit dhe informacionit për studentët e NjKTI.</p> <p>(Evidenca 6_Rregullore UMAD, Neni 69, Neni 70, Neni 72 dhe Neni 75; Evidenca 7_Nenet 52-56 dhe 59-63)</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen mbi përmbajtjen e syllabusit të çdo lënde që në orën e parë të mësimi. Çdo syllabus është i ndërtuar bazuar në legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e MASR dhe përgjithsisht përmbajnë të gjitha elementet informuese për studentin. Të gjitha këto elemente e njohin studentin me metodologjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënjes si edhe me metodat e vlerësimit (Evidenca 6_Rregullore e NjKTI neni 52 pika 6 dhe 9).</p> <p>Javën e parë të mësimi, studentët NjKTI organizon javën e orientimit për të informuar studentët e viteve të para në lidhje me rregullat e vlerësimit dhe jo vetëm.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Syllabusi përmban informacionin e nevojshëm për mënyrën e vlerësimit të studentit si provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi final. Por për shkak të natyrës praktike të programit të studimit lektorët inkurajojnë studentët të realizojnë detyra praktike dhe të ndihmojnë në përfitimin e më shumë njohurive praktike dhe i reflektojnë këto njohuri praktike në pyetjet e provimit</p> <p>(Evidenca 6_Rregullore e UAMD, neni 68, Evidenca 7_Rregullore e NjKTI neni 52)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.3</p>	
<p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Forma e vetme e kontrollit të dijës në Universitetin "Aleksandër Moisiu" është provimi me shkrim. Për çdo kurs 10% e vlerësimit të bazohet në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe sipas programit të kursit të miratuar. Mënyra e organizimit të lëndëve është e tillë që studentët të punojnë në mënyrë individuale ose në grup për të kryer projekte apo detyra në mënyrë që të jenë vazhdimisht në vlerësim. Lëndët janë të organizuara në 15 javë dhe në dy provime (i ndërmjetëm dhe final) dhe në vlerësimin final merret parasysh edhe Detyra e Kursit. Çdo formë vlerësimi apo detyre/projekti gjatë mësimdhënies ju bëhen të ditura studentëve që në javën e parë dhe janë të pasqyruara në syllabuset e çdo kursi.</p> <p>(Evidenca 6_Rregullore UMAD, Neni 69, Neni 70, Neni 72 dhe Neni 75; Evidenca 7_Rregullore e NjKTI, Nenet 52-56 dhe 59-63; Evidenca</p>

	23_Rregullore e programit të studimit, Neni 16 dhe KREU III)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Pas përfundimit të provimit, studentët njihen me çelësin e tezës dhe lektori u cakton një seancë ku i njeh ata me vlerësimin përfundimtar dhe studentët kanë të drejtë të shikojnë tezat e tyre të provimeve. Më pas çdo lektor hedh vlerësimet në sistemin Pitagora dhe studentët mund të marrin online vlerësimet brenda 72 orëve pas provimit përfundimtar. Gjithashtu</p> <p>UAMD ka një marrëveshje bashkëpunimi si pjesë e projektit Clean Score të mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. Çdo personel akademik i FTI që ka dëshirë të realizojë vlerësimin elektronik të provimeve e ka mundësinë për ta aplikuar këtë metodë si pjesë e këtij bashkëpunimi.</p> <p>(https://cleanscore.al/arkiva/794)</p>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Vlerësimi përfundimtar i studentëve gjatë sezonit të rregullt të mësimit bëhet në përputhje të me syllabusin nga lektori i kursit. Në sezonin e riprovimeve vlerësimi bëhet nga një komision me tre lektorë që kanë formimin specifik. Titullari i kursit është kryetar i komisionit për lëndën dhe dy lektorët e tjerë janë anëtarë.</p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Në çdo vlerësim të vazhdueshëm gjatë kursit, por edhe në provimet (të ndërmjetëm apo final), studentët njihen konkretisht me mënyrën dhe rezultatin e vlerësimit. Kjo shoqërohet edhe me këshillim apo sugjerime nga ana e lektorit për të ndihmuar studentin në zhvillimin profesional. Në raste paqartësisht, studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura.</p> <p>(Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, Nenet 54-56)</p>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Cdo lektor në fillim të kursit informon studentët për detyrimet e tyre dhe mbi të gjitha për kujdesin që duhet të tregojnë me plagjiaturën, respektimin e të drejtës së autorit, citimin e saktë të çdo burimi të referuar dhe mbi të gjitha për pasojat e plagjiaturës. Në rast se një student nuk i respekton, vlerësohet automatikisht me note jokalue. Gjithashtu studenti informohet edhe për respektimin e procesit të provimit, ku nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me lektorin e kursit; nuk lejohet përdorimi i celularit dhe në rast se studenti kapet me kopje nga lektori apo nga asistuesi i tij, studenti ndërpret provimin dhe merren masa për plotësimin e procesverbalit nga lektori i kursit dhe asistuesi përkatës.</p> <p>(Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, neni 88, pika d)</p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Pas zhvillimit të testimit ndërmjetës, në orën pasardhëse të mësimit, personeli akademik sqaron studentët për rezultatet e provimeve dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të stafit akademik të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Në rastin e provimit përfundimtar stafi akademik i kursit cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Stafi akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme. Në rast problemesh me sistemin stafi akademik i kursit informon përgjegjësin e departamentit.</p>

	(Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, neni 53, pika 7)			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Statuti dhe Rregullorja e UAMD i garanton studentit të drejtat përfshirë këtu njohjen me vlerësimin përfundimtar. Provimet zhvillohen në përputhje me çdo rregull dhe standard institucional, të cilat ndiqen me përpikmëri nga stafi akademik. (Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, neni 54, pika gj)			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtë të ankohet nëpërmjet një kërkesë drejtuar dekanit të NJKTI për rezultatin përfundimtar të provimit brenda afateve të parashikuara në rregullore. Kur kërkesa miratohet, brenda 48 orësh nga ankimimi, përgjegjësi i njësisë bazë, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Procedura ruhet në protokollin e NJKTI. (Evidenca 6- Rregullore UAMD, Neni 71; Evidenca 7- Rregullore FTI, Neni 56)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara, me karakter praktik profesional në fushën e elektronikës. Ky program organizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është dy vite akademike. Objektivat dhe kompetencat e programit të studimit janë aftësimi praktik i studentëve për mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve dhe pajisjeve elektronike; aftësimin e studentëve në njohjen e komponenteve të pajisjeve elektronike, qarqeve, gjysmëpërçuesve dhe sistemeve; të kombinojë njohuritë teorike dhe praktike të fushës së elektronikës për të realizuar detyra të ndryshme etj. Çdo student që përfundon programin e studimit MP në MTVD është i aftë për të qenë konkurues në tregun e punës. (Evidenca 2_Objektivat e programit të studimit)
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi profesional i studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” fokusohet plotësisht në përfitimin e njohurive specifike të orientuara drejt fushës së elektronikës. (Evidenca 8_Plani i zhvillimit strategjik të UAMD)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e	Syllabuset e kurseve përmbajnë qëllimin, objektivat, kompetencat e synuara dhe aftësitë që duhet të fitojë studenti në përfundim të kursit. Lektorët para zhvillimit të testeve bëjnë përmbledhjen e koncepteve bazë të

çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	marra gjatë zhvillimit të programit, u përgjigjet pyetjeve të tyre dhe i udhëzon studentët lidhur me provimin. Në ditën e provimit përfundimtar (pas dorëzimit të tesit) student njihet edhe me zgjidhjen e tezës së provimit (zbardhja e çelësit të provimeve).			
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia për studentët e programit profesional të studimit "Specialist Pajisjesh Elektronike" zhvillohet më së shumti në laboratorin 015, 103 dhe 203 duke mundësuar zhvillimin e shembujve praktikë ose simulimin e qarqeve elektronike me programe profesionale. Kjo metodologji ka rezultuar efikase pasi studentët realizojnë projekte dhe punime praktike përgjatë gjithë lëndës. Gjithashtu është duke u vënë në punë një laborator specifik për programin profesional të studimit "Specialist Pajisjesh Elektronike". Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie përdor si formë mësimdhënie edhe diskutimet.			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Përgjatë vitit akademik, NJKTI organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët e saj. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik i NJKTI (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor. (Evidenca 15_Tabela e mobiliteteve për dy vitet e fundit; Evidenca 30 _Rregullore Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DPMJ) dhe Evidenca 14- Listë MoU)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Në përfundim të programit të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës. Për të marrë pjesë në provimin studentit duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e tjera të kurrikulës. Ai mund të regjistrohet vetëm pasi shlyerja e këtyre detyrimeve konfirmohet nga sekretaria e NJKTI-së. (Evidenca 7_Rregullore e NjKTI, Neni 59-62; Evidenca 6_Rregullore e UAMD; Neni 76-79)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe	Website zyrtar https://www.uamd.edu.al , përdorimi i rrjeteve sociale,

<p>personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>ambjenti i sekretarisë shërbejnë si burim i të gjithë informacionit të nevojshëm për ndjekjen e provimit të diplomës, lista e pyetjeve të provimit përfundimtar dhe datat kryesore të zhvillimit të procesit.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Teza e provimit të diplomimit bazohet në 5-6 lëndë bazë të programit të studimit, të cilat përcaktohen çdo vit me propozim nga njësia bazë dhe me vendim dekanati. Provimi i diplomës zhvillohet me një provim të vetëm me 1000 pikë, që përmban pyetje nga të gjitha lëndët bazë të përcaktuara nga njësia bazë. Raporti i pikëve sipas lëndëve përcaktohet me vendim të njësia bazë.</p> <p>Gjatë gjithë vitit akademik, personeli akademik me kohë të plotë ofron për studentët 5 orë konsultimi në javë për ti orientuar ata për çdo paqartësi që mund të kenë në lidhje me lëndët përkatëse.</p> <p><i>(Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, NENI 62)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Detyrimi përmbyllës për studentët e programit të studimit “Specialist pajisjesh elektronike” është provimi përmbyllës i diplomimit. Fondi i pyetjeve u bëhet me dije studentëve në fillim të semestrit të dytë dhe ata mund të konsultohen me lektorët në mënyrë periodike nëpërmjet orëve të konsultimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>	<p>Detyrimi përmbyllës i programit të studimit është provimi i diplomimit.</p> <p><i>(Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, NENI 62)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi i testit të diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga njësia bazë përkatëse dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë.</p> <p><i>(Evidenca 7_Rregullore e NjKTI, Neni 61, 62)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. “Diploma Profesionale” që lëshohen në përfundim të programeve të studimit në Njësia kryesoren e Teknologjisë së Informacionit shoqërohen me suplementin e diplomës. 2. NjKTI nuk mund të lëshojë dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, i cili duhet të përmbajë emrin e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, numrin e diplomës origjinale, datën e lëshimit të saj, ciklin dhe programin e studimit, si dhe listë notash, vërtetime dhe programi lëndor për çdo kurs.. 3. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit.

Drop 

	<p>4. Studentët që në përfundim të studimeve të plota kanë të gjitha lëndët të vlerësuara me notën dhjetë fitojnë çertifikatën “Medalje të Artë”. Studenti që ka mesataren më të lartë fiton çertifikatën “Student i Shkëlqyer, sipas kriterëve që përcaktohen me vendim të Senatit Akademik.</p> <p>Formati i “Diplomë profesionale” për studentët e “Specialist pajisjesh elektronike” pritet të aprovohet nga QSHA..</p> <p>(<i>Evidenca 6</i> - Rregullore e Njesisë Kryesore të Teknologjisë së Informacionit (NjKTI), Neni 63 dhe 72; <i>Evidenca 20</i>_Suplementi i diplomës)</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Ndër detyrat e sekretarisë mësimore të NjKTI dhe Kryesekretares është arkivimi dhe ruajtja e dokumentacionit dhe informacionit për studentët e NjKTI⁵⁹. Në cdo kohë studenti mund të kërkojë dhe duhet t’i vihet në dispozicion nga sekretaria mësimore listë notash, vërtetime dhe programi lëndor për cdo kurs.</p> <p>(<i>Evidenca 6</i>_Rregullore e NjKTI, Neni 67)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.6</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies, sigurohet përmes pranisë së strukturave ndihmëse institucionale, që ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit; Dega mësimore ndihmon në përmirësimin e infrastrukturës dhe pajisjeve logjistike, në dobi të rritjes së efikasitetit të procesit mësimor. Ajo funksionon si struktura në të cilin konvergojnë veprimtaritë mësimdhënëse dhe ato administrative. UAMD praktikon një formë të re interaktive dhe inovatore të gërshetimit të orëve të leksionit me seminarin, që nxit debatin pedagog – student. Format kryesore të procesit mësimor në programin e studimit profesional në SPE janë leksionet e integruara me shembuj praktikë dhe projektet e realizuara nga studentët. Lektorët për të siguruar mësimdhënie cilësore përdorin metoda bashkëkohore bazuar në eksperiencën e universiteve homologe të vendeve të zhvilluara të BE. Tashmë prezantimet bëhen me kompjuter/laptop dhe projektor, ku paraqiten jo vetëm leksionet në powerpoint, por edhe me video apo ilustrime të tjera sipas nevojës. Studenti është në qendër të vëmendjes dhe orët e mësimit në janë interaktive duke u realizuar edhe në formën e diskutimit.</p> <p>(<i>Evidenca 17</i>- Rregullore për Funkionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë NjBSC)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse</p>	<p>Dega Mësimore dhe Sektori i Kurrikulave pranë UAMD zhvillon vlerësimin</p>

<p>zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>periodik të lektorëve dhe mënyrës së realizimit të mësimdhënies me anë të pyetësorëve. Çdo student duhet të plotësojë në mënyrë anonime këtë pyetësor për çdo lektor të kurseve që zhvillon në atë semester. Ky pyetësor realizohet në të dy semestrat e vitit akademik. Tek program i studimit profesional SPE është organizuar pyetësor për studentët për kurse të ndryshëm të të zhvilluar.</p> <p><i>(Evidenca 31_Përmbledhëse e formularit të vlerësimit kërkimor shkencor 2020-2022, Evidenca 32_Formular vetëvlerësimi)</i></p> <p>Drejtoria e Kurrikulave dhe Cilësisë monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike performancën e stafit akademik nëpërmjet formularëve dhe pyetësorëve, konkretisht si: Formulari i vetëvlerësimit nga lektorët, formulari i kërkimit shkencor, rikontrolli i provimeve për vitin akademik, vlerësimi i studentëve dhe monitorimi i prezencës së stafit gjatë mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidencë 33_Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, Evidenca 34_Memo mbi rikontrollin e provimeve)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e pyetësorëve skanohen me anë të lexuesit optik, përpunohen dhe ju bëhen të njohura njëjësive kryesore dhe njëjësive bazë përkatëse. Çdo lektor me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që janë të angazhuar në çdo semester në mësimdhënie informohen me email për rezultatet e vlerësimit nga pyetësorët e studentëve duke ruajtur privatësinë e informacionit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara NJKTI dhe NJBTI. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelin akademik, përgjegjësit e njëjësive bazë analizojnë rezultatet e ankimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuar për përmirësimin e tyre në të ardhmen. UAMD inkurajon përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe promovon diversitetin, përfshirjen, barazinë, profesionalizmin dhe mundësinë për të siguruar një edukim model elitar të specialistëve të të gjitha programeve të studimit. Gjithashtu UAMD nxit bashkëpunime dhe ndërmer nisma institucionale për trajnimin e personelit akademik, në funksion të përmirësimit të mësimdhënies. Këtu përmendim trajnim të lektorëve nga në kuadër të programit Tempus dhe Erasmus+. Institucioni monitoron dhe kontrollon mbarëvajtjen dhe cilësinë e mësimdhënies, përmes kontrollit të vazhdueshëm, që kryhet përmes Sekretarisë Mësimore, si: mbajtjes së listë prezencës së ndjekjes së orës së mësimit nga pedagogët; vlerësimit të performancës në mësimdhënie nga Drejtuesi i Njësisë Bazë; dega mësimore angazhohet për matjen e performancës së mësimdhënies, në bazë të vlerësimit të studentëve, etj. Në bazë të këtyre të dhënave, si dhe informacioneve të dorëzuara në Dosjen e Vetëvlerësimit hartohet formulari i vlerësimit për çdo lektor. Më tej ky vlerësim depozitohet tek Dekani.</p> <p><i>(Evidenca 32_Formular i vetëvlerësimit)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

(Handwritten signatures and marks)

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Programi i studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” mbulohet pothuajse plotësisht nga personeli akademik me kohë të plotë.</p> <p>(Evidenca 40_ Tabela e stafit të angazhuar në programin e studimit)</p> <p>Të gjithë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë të kategorive asistent lektor, lektor dhe profesor i asociuar duke përmbushur kërkesën ligjore që personeli akademik i angazhuar duhet të ketë një nivel kualifikimi më të lartë se cikli i studimeve ku angazhohen në mësimdhënie.</p> <p>(Evidenca 35_Stafi akademik i NJBTI; Evidenca 36_Stafi ndihmës akademik që mbulon programin e studimit SPE)</p> <p>NJKTI është pjesë e disa projekteve ndërkombëtare, ka disa marrëveshje bashkëpunimi me Universitete Europiane dhe shqiptare. (Evidenca 13_ Tabela e marreveshjeve)</p> <p>Konkretisht stafi akademik i angazhuar në programin e studimit “Specialist pajisjesh elektronike” është trajnuar në kuadrin e Projektit Erasmus + në Universitetin e Tartusë (Estoni), Universitetin e Ljubjanës (Slloveni), Universitetin e Ostravës (Çeki), Universitetin e Prishtinës, Universitetin Epoka, etj. Universitetin e Sarajevës, në Universitetin Kapodastrian të Athinës, në Universitetin Leuven të Belgjikës, në Universitetin Teknik të Sofias, etj. Në fushën e Teknologjisë së Informacionit, pjesë e të cilit është edhe ky program studimi.</p> <p>Njësia Bazë nxit stafin akademik të programit të studimit të marrë pjesë në aplikimin e projekteve shkencore, botime shkencore, etj.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv	Ngarkesa mësimore e personelit akademik është gjithmonë me përputhje me

Drion

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

<p>duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>kornizën ligjore në fuqi. Kjo ngarkesë miratohet çdo semestër nga NJBTI / NJKTI si dhe monitorohet nga rektorati dhe zyrat përkatëse për tu siguruar që orët vjetore në auditor si dhe numri i lëndëve për çdo semestër të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet cilësore të UAMD.</p> <p><i>(Evidenca 38_Ngarkesa e stafit akademik, Evidencë 37_Analizë e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Personeli akademik i NJBTI i angazhuar në këtë program studimi ka lidhur një kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë asistent lektor dhe me afat të pacaktuar për kategoritë lektor dhe profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Edhe në rastet e kontratave me kohë të caktuar, rinovimi i tyre bëhet automatikisht bazuar në rekomandimin e përgjegjësit të NJBTI dhe dekanit të NJKTI në rastet kur performanca e personelit akademik është në nivelin e kërkuar.</p> <p>UAMD siguron mbulimin me korrektësi të të gjitha detyrimeve financiare duke përfshirë edhe mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>(Evidenca 39_ Kontratat e punësimit të stafit të NJBTI)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik pranë NJKTI zhvillohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe sipas procedurave të pasqyruara në rregulloret e UAMD.</p> <p>NJKTI / UAMD shpall konkursin për vende të lira pune, sipas strukturës së përgjithshme në nivel institucional, të miratuar nga Bordi Administrimit dhe kryen publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu njoftimet publikohen dhe në faqen zyrtare të UAMD së bashku me formularët e aplikimit.</p> <p>Komisioni ad-hoc, i ngritur nga dekani i NJKTI, bën vlerësimin e kandidatave në dy faza, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve (që kanë nivelin e duhur të kualifikimit) i nënshtrohen intervistës.</p> <p><i>(Evidenca 6_ Rregullore UAMD, nenet 103-106)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në strukturën e NJKTI aktualisht janë pesë personel ndihmës akademik ku secili prej tyre është përgjegjës për mirëmbajtjen e një laboratorit të caktuar.</p> <p>Ky personel ndihmës akademik ka përfunduar studimet kryesisht në profilet e teknologjisë së informacionit dhe kanë kualifikimin e duhur dhe aftësitë për të mbuluar detyrimet e tyre për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe ofrimin e mbështetjes për personelin akademik për zhvillimin e orëve mësimore apo praktikave profesionale në këto laboratore.</p> <p><i>(Evidenca 36_Stafi ndihmës akademik per programin profesional SPE</i></p> <p>Për të arritur objektivat e programit të studimit më së shumti shfrytëzohen ambjente e laboratorëve 015, 103, 203 dhe ambjentet e reja që janë duke u krijuar. Se shpejt do të ndërtohet laboratorit i posaçem i degës "Specialist Pjësish Elektronike", i cili do të pajiset me të gjitha pajisjet e nevojshme për ndertimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen pajisjeve elektronike të fushave të ndryshme.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në</p>	<p>Personeli akademik deklaron çdo vit ecurinë akademike shkencore dhe ngarkesën mësimore semestrale dhe vjetore.</p> <p>NJBTI analizon ngarkesën mësimore të vitit aktual, nevojat dhe kërkesat për</p>

<p>programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>staf akademik në programin profesional të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”, duke përpiluar një dokument informues lidhur me parashikimin e ngarkesës për vitin e ri akademik.</p> <p>Dega mësimore ruan informacionin e duhur për aktivitetin mësimor të programit të studimit. Nëpërmjet informacionit të ofruar nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Dega Mësimore ndihmon në përgatitjen e raporteve dhe statistikave për Njësinë Kryesore dhe Bazë.</p> <p>(Evidenca 37_Analize vjetore e Njësisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit për vitin 2021-2022, Evidenca 38_Ngarkesa e lektorëve, Evidenca 40_Tabela e kualifikimeve të stafit të NJBTI)</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>FTI është pjesë e disa projekteve ndërkombëtare, ka disa marrëveshje bashkëpunimi me Universitete Europiane dhe shqiptare.</p> <p>(Evidenca 13. Marreshjet e nenshkruara per vitet 2020-2022, Evidenca 14. Listë MoU).</p> <p>Konkretisht stafi akademik i angazhuar në programin e studimit SPE është trajnuar në kuadrin e Projektit Erasmus + në Universitetin e Tartusë (Estoni), Universitetin e Ljubjanës (Slloveni), Universitetin e Ostravës (Çeki), Universitetin e Prishtinës, Universitetin Epoka, etj. Ev. Të gjitha trajnimet e kryera nga personeli vihen në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies për këtë program studimi.</p> <p>Kurset e fokusuara në aspektin praktik e zhvillojnë mësimin e tyre në laboratorët që NJKTI disponon falë pjesëmarrjes në projekte të ndryshme kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimit me bizneset partnere. Struktura e personelit akademik të NJKTI-së është e përbërë nga 44 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët 13 janë staf i NJBTI, të cilët janë të angazhuar me mbikëqyrjen e studentëve për detyrimet përmbyllëse si dhe në çdo veprimtari tjetër përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre.</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Studenti nuk ka ne kurrikulën e programit të studimit lëndën e praktikës profesionale, por lende qe ndihmojne ne formimin profesional te studentit persa i perket diagnostifikimit, mirembajtjes, riparimit të pajisjeve elektronike. Në kurset e formimit profesional mund të zhvillohen aktivitete shtesë (jashtë kurrikulës) me kërkesë të studentit ose bizneseve partnere, të cilët krijojnë kushtet e duhura për të ndihmuar studentët në aftësimin e tyre të mëtejshëm profesional.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>NJKTI zotëron klasa dhe ambiente të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore me karakter teorik dhe profesional të pajisura me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore për lëndë të këtij profile: dy laboratorë të profilit të multimedias (sallat 103 dhe 203), si dhe një laborator kërkimor (salla 015). Këta laboratorë kanë lidhje interneti, 20-30 PC me parametra të përshtatshëm dhe të kompletuar me programet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor dhe aftësim praktik profesional, LED screen 65" ose projektore HD për zhvillimin e procesit mësimor në kushte optimale, kamera survejimi, një laborant të dedikuar vetëm për mirëmbajtjen teknike të këtij laboratorit dhe për të asistuar stafin akademik që zhvillon procesin mësimor dhe praktikat në këtë laborator, sistem kondicionimi, kapacitet për zhvillim leksionesh për 40-60 studentë, lap top për stafin akademik që zhvillon aktivitetin mësimor në këtë laborator.</p> <p>Kurset profesionale për këtë program studimi e zhvillojnë aktivitetin e tyre në këto ambiente.</p> <p>Përveç përdorimit të këtyre ambienteve, NJKTI ka në përdorim edhe 7 auditorë mësimor me kapacitet total 420 vende (sallat 104, 105, 107, 108, 110, 210, 220). Një objektiv i rëndësishëm i SPE është ndërthurrja e pjesës teorike me atë praktike. Për të arritur këtë objektiv janë krijuar disa ambiente të përshtatshme 015, 103, 203 dhe ambientet e reja që janë duke u krijuar.</p> <p><i>(Evidenca 41_Foto nga labororet)</i></p>			
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>				
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>UAMD zotëron disa laboratore të teknologjisë së informacionit. Në laboratorin 203 është instaluar programi I simulimit të pajisjeve elektronike (MULTISIM), student mund të ndërtojë skema amplifikatorësh me elemente diskretë dhe skema me amplifikatoroperacional, të vlerësojë madhësitë elektrike nëpërmjetnjihet me skemat model aparateve matëse, si dhe mund të njihet me skemat model të vetë programit, si funksionojnë ato, si ndryshojnë vlerat e madhësive elektrike, etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të</p>	<p>Çdo vit personeli akademik propozon literatura të ndryshme sipas profileve për pasurimin e bazës materiale të bibliotekës. Bazuar në këto propozime</p>

<p>studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>UAMD përditëson fondin ekzistues bazuar në buxhetin e miratuar për këtë funksion për atë vit akademik.</p> <p>Gjithashtu secili lektor <i>siguron ciklin e leksioneve</i> për kursin që mbulon në mënyrë elektronike dhe fizike. Studenti mund të përdorë ciklet fizike të leksioneve në lëndët bazë: Elektronika 1, Elektronika 2, Logjika Dixhitale, etj.</p> <p>E gjithë literatura e detyruar e kurseve ofrohet në gjuhën e programit të studimit (shqip) kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Kjo literaturë është e përshtatshme për të dhënë njohuritë e kërkuara për këtë program studimi</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e SPE kanë akses në bibliotekën e UAMD. Për tu përshtatur me oraret e mësimit të programeve të ciklit të studimeve, biblioteka funksionon edhe në fundjavë.</p> <p>Biblioteka arkivon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Ajo funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 8576, datë 3.2.2000, Neni 30, "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë". Ajo kryen dixhitalizimin e skedarëve dhe ka në fondin e saj rreth 8000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Ajo shkëmben informacion me biblioteka të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit.. Biblioteka ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit. Të njëjtën mënyrë funksionimi ndjekin edhe bibliotekat në dy godinat e tjera të Universitetit të cilat janë nën varësinë e Bibliotekës së Godinës qendrore. Biblioteka në godinën 1, kampusi i ri ka një sipërfaqe prej 238.8m² dhe kapacitet prej 120 vendësh.</p> <p>(<i>Evidenca 42</i>_ Urdhër për funksionimin e bibliotekës në fundjavë, <i>Evidenca 49</i>_ Rregullorja e bibliotekës)</p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik me standarde ndërkombëtare. Biblioteka universitare garanton literaturë kryesisht të viteve të fundit, tekste mësimore dhe plotësuese, në përputhje me kurrikulat mësimore. Numri i kopjeve për çdo titull varion nga 2-5 kopje mesatarisht ndërsa kopjet e librit të huaj variojnë nga 1- 2 kopje. Krahas librit fizik, ekziston edhe libri elektronik. Biblioteka universitare është hibride dhe me fonde të hapura. Aktualisht në UAMD janë funksionale 3 biblioteka. Koleksioni i tyre përfshin burime që plotësojnë nevojat e të gjithë përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma. Pasurimi i koleksioneve në përputhje me kurrikulat mësimore është i vazhdueshëm, por jo periodik, në varësi të mundësive buxhetore dhe kryhet nëpërmjet: blerjeve, dhurimeve, shkëmbimit të materialeve mes bibliotekave, artikujve shkencorë, tezave dhe dizertacioneve. Pasurimi periodik me botimet e Bashkimit Evropian kryhet edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme, ku UAMD është Institucion Leader ose partner. Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore. Biblioteka posedon një literaturë shumëdisiplinore, duke mbështetur kurrikulat e të gjithë fakulteteve të universitetit.</p> <p>(<i>Evidenca 42</i>_ Urdhër për funksionimin e bibliotekës në fundjavë, <i>Evidenca 49</i>_ Rregullorja e bibliotekës)</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Me shfrytëzimin e sistemeve me bazë “kod të hapur”, mbështetur në udhëzimet e BE-së, Nenit 179 të Traktatit të Lisbonës mbi burimet e hapura (open access), me mbështetjen e IFLA-s, biblioteka e Universitetit instaloi falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj.</p> <p>(https://ulibrary.rash.al/)</p>			
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>Ambjentet e bibliotekës ofrojnë PC, programe të përshtatshme sipas programeve të studimit të studentëve, akses në literaturë fizike në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj sipas fakulteteve, akses në biblioteka online bazuar në marrëveshjet e UAMD.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në Web-in e universitetit. Çdo student/ pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studenti disponon një kartelë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajiset me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave, për navigimin në burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik.</p> <p>Biblioteka ofron akses gjatë gjithë ditëve të javës në orët e përshtatshme për shfrytëzimin e e saj nga studentët e programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 49 _Rregullorja e bibliotekës)</i></p>			
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Ne zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 4 dhe nenit 7, Kreu I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, biblioteka në bashkëpunim me fakultetet dorëzon pranë drejtorisë së menaxhimit financiar kërkesat për blerje librash, materiale, pajisje, rafte, skanera, kompjutera, etj. Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore. Institucioni (Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike) harton plane për përditësimin e fondit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët</p>	<p>Institucioni disponon librin e gjeneraliteteve, librin e arritjeve akademike, librin e diplomave dhe certifikatave, regjistrat lëndor, ku paraqitet informacioni lidhur me të gjithë aktivitetin e studentëve. Aktualisht në funksion të NJKTI është sistemi Pitagora, i cili administron të dhënat e</p>

dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	studentëve dhe i ofron atyre një hapësirë vetjake për të aksesuar notat, ndërtuar orarin etj. Ky sistem aplikohet për studentët e programit të studimit SPE. (https://uamd.pitagora.rash.al/)
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Të gjitha këto funksione ofrohen aktualisht nga sistemi Pitagora për ciklet e ë studimeve sipas marrëveshjes mes UAMD dhe RASH. Çdo përdorues për sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në NJKTI/UAMD: - Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. - Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj. - Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në këtë sistem janë të përfshira ndërfaqet për studentët, personelin akademik, sekretarinë mësimore dhe zyrën e finances për verifikimin e pagesave.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Në këtë sistem janë të përfshira ndërfaqet për studentët, personelin akademik, sekretarinë mësimore dhe zyrën e finances për verifikimin e pagesave.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera. Këto të dhëna janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtarit të personelit të NJKTI. Të dhënat janë të ruajtura për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e NJKTI. Linku i sistemit të menaxhimit të informacionit ndodhet më poshtë: (https://uamd.pitagora.rash.al/)
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Të dhënat për programin e studimit SPE janë të publikuara në faqen zyrtare të UAMD në seksionin e dedikuar për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, me linkun e mëposhtëm: https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/ https://uamd.edu.al është faqja zyrtare e UAMD, ku përtej çdo informacioni të mundshëm në lidhje me institucionin kemi dhe informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet përkatëse. 1. Nën menunë e NJBTI gjendet informacion i detajuar në shqip dhe anglisht mbi personelin akademik, misionin dhe vizionin, kurrikula, dhe syllabuset përkatëse si dhe kriteret e aplikimit për tek programi i studimit. 2. Për të marrë informacionin e nevojshëm mbi përmbajtjen e programit të studimit në website lançohet çdo informacion apo thirrje mbi leksione të hapura, aktivitete të tjera. 3. Institucioni publikon foto nga çdo aktivitet, thirrje dhe çdo

	informacion të mundshëm në faqen e Facebook, Instagram dhe LinkedIn.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

3

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Raportet financiare të UAMD nuk realizohen në rang programi studimi. Raportet financiare realizohen në rang institucional duke diversifikuar shpërndarjen e kostove dhe të ardhurave midis programeve të studimit që ofron UAMD.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Mbështetja e UAMD për programin e studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” është kryesisht për pagat e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, personelit ndihmës - akademik në shërbim të programit të studimit SPE dhe për mirëmbajtjen e ambjenteve në dispozicion të këtij programi. Një tjetër mbështetje është edhe ofrimi i bursave për një pjesë të studentëve si dhe shpenzimet për bibliotekën.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Koordinimi i propozimeve të njësisë kryesore realizohet nga administratori i UAMD, i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe harton planin strategjik financiar, që i paraqitet për miratim bordit të administrimit.
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket programit të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”, kohëzgjatja është 2 vite akademike, që nënkupton garantimin e qëndrueshmërisë financiare për kohëzgjatjen e këtij programi, mjafton miratimi i buxhetit për vitin pasardhës. Gjatë këtyre viteve programi I studimit ka patur numër të regjistruarish të konsiderueshëm, gje tregon për zhvillim të qëndrueshëm të këtij programi studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Mbështetur në direktivat e Ministrisë dhe legjislacionit në fuqi, Institucioni i arsimit të lartë ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar një process legjitim dhe të strukturuar që mbështet ciklin e plotë akademik të studentëve.</p> <p>Cdo njësi bazë, në kohën e duhur, dërgon kërkesën e saj drejt Ministrisë përsa i përket kuatave të programeve të studimit të vitit të ardhshëm. Njësia bazë e programit të studimit (NJBTI) gjithashtu harton kriteret e pranimit të studentëve mbasi ka marr miratimin e antarëve të njësisë bazë dhe grupit përgjegjës për programin e studimit. Bazuar në udhëzimet e MASR realizohet edhe shpallja e fituesve si dhe regjistrimi i tyre me dokumentacionin e kërkuar dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim. Më pas ngrihet komisioni I regjistrimit të studentëve të cilët për një periudhë 1 mujore me 15 faza, regjistrojnë të gjithë studentët në programin fitues. Studenti mbasi hyn në programin e studimit duhet të përmbush të gjitha detyrimet dhe më pas të diplomohet sipas rregullores, statutit dhe ligjit në fuqi.</p> <p><i>(Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, nenet 1,2)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga</p>	<p>Legjislacioni por dhe politika e ngritjes së komisioneve përkatëse përmbushin</p>

<p>hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit</p>	<p>krijimin e një ambjenti të barabartë për të gjithë studentët. Këtu mund të përmendim, ngritja e grupeve të pranimit të studentëve ku vlerësimi bëhet bazuar vetëm dhe vetëm nga pikët përkatëse. Nga ana tjetër Kodi i Etikës së UAMD-së nuk toleron trajtim jo të barabartë të studentëve. Të gjithë kanë të drejta dhe detyrime njëjloj, kanë akses në të njëjtat ambiente dhe përdorin të njëjtën infrastrukturë sipas nevojës.</p> <p><i>(Evidenca 29_Kodi I etikës, neni 6), Evidenca 7_Regullore e NJKTI, neni2, pika dh)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik, NJBTI propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve të programit profesional "Specialist Pajisjesh Elektronike". Kriteret e pranimit të studentëve në programin profesional "Specialist Pajisjesh Elektronike" miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD, bazuar në propozimet e NJBTI dhe NJKTI. Këto kritere, si të gjitha vendimet e senatit, publikohen në faqen elektronike zyrtare të UAMD. Gjithashtu njoftimet për kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet publikohen edhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD dhe NJKTI.</p> <p><i>(Evidenca 7_Regullore e NJKTI, neni 33)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit në programin e studimit dy-vjeçar janë të bazuara në vendim Senati Akademik mbi pranimin e studentëve të programit profesionale dy-vjeçarë "Specialist pajisjesh elektronike". Për t'u pranuar në një program studimi dy-vjeçar, kandidati duhet të zotërojë Diplomë të Shkollës së Mesme të Përgjithshme ose Profesionale të fituar brenda vendit apo jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të. Institucionet publike të Arsimit të Lartë, përcaktojnë dhe publikojnë listën e kriterëve për çdo vit akademik që mundësojnë pranimin në një program sipas legjislacionit dhe rregullores përkatëse të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në fuqi.</p> <p>Përsa i përket procedurave të transferimit të krediteve, ato janë të përcaktuara qartë në rregulloret e institucionit.</p> <p><i>(Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, neni 38, 39)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Cdo fillim viti akademik, NJBTI parashikon kuotat dhe propozon kriteret e pranimit, si dhe kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, si: studente që vijnë nga familje që trajtohen me ndihme ekonomike, studente që janë vete me aftësi të kufizuara, studente që kanë statusin "jetim", studentët, të cilët i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuara me vendim të</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.</p> <p>UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi			
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Mbështetur në direktivat e ministrisë, dhe legjisllacionit në fuqi Institucioni ndërmer të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar një proces legjitim dhe të strukturuar që mbështet të gjithë aktivitetin e studentëve nga momenti i regjistrimit në një program studimi deri në përfundim të detyrimeve të tij.</p> <p>(<i>Evidenca 6</i>_Rregullore e UAMD, KREU III Organizimi i Studimeve, Neni 42; <i>Evidenca 7</i>_Rregullore e NJKTI Kreu III Organizimi i studimeve)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Sekretaria Mësimore e NJKTI nëpërmjet sekretareve të secilit program studimi informojnë të gjithë studentët e interesuar mbi njohjen dhe ekuivalentimin e lëndëve. Studentët që duan të transferohen do të dorëzojnë kërkesën e tyre në Fakultetin përkatës. Ngrihen komisione ad-hoc nga njësia bazë për vlerësimin e aplikimeve. Rezultatet e grupit të punës i bëhen të njohura studentit. (<i>Evidenca 6</i>_Rregullore e UAMD, KREU III, neni 38)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët informohen në lidhje me mënyrën e vlerësimit për çdo lëndë nga lektorët përkatës. Syllabusi i cdo lënde i jepet studentit së bashku me sistemin e vlerësimit. Mënyra e vlerësimit është me dy provime, të cilët kanë përkatësisht një vlerësim prej 400 pikë i pari dhe 500 pikë i dyti. Ndërkohë që një vlerësim prej 100 pikë i përket detyrave të kursit apo projektit të dhënë prej pedagogut të lëndës. Në total studenti do të mund të përfitojë 1000 pikë maksimale. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara. Gjithashtu sistemi i vlerësimit gjentet tek rregullorja e UAMD, e cila është e publikuar dhe online në faqen e WEB-it të institucionit. . (<i>Evidenca 6</i>_Rregullore e UAMD, KREU III, neni 52)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentët përfundojnë studimet në programin e studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” me provim diplomimi. Pyetjet e provimit të diplomimit hartohen nga lektorët e NJBTI të cilët janë të angazhuar në mësimdhënie në lëndët e formimit profesional. NJBTI përzgjedh lëndët, të cilat përfshihen në provimin e diplomimit. Këto pyetje publikohen në faqen e UAMD në WEB. (<i>Evidenca 6</i>_Rregullore e UAMD, KREU III, neni 59, 60, 61, 62, 63)</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Në nivel Institucioni, cdo vit organizohen takime të hapura dhe promovuese lidhur me informimin e të intersuarve mbi programin e studimit jo vetëm brenda qytetit të Durrësit, por edhe më gjerë. Gjithashtu organizohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantime të vazhdueshme në lidhje me mundësitë e punësimit, që ofron ky program studimi • Open Days në rast se studenti kërkon të shoh kushtet laboratorike përpara se të regjistrohet në programin e studimit. <p>Cdo anëtar i NJBTI sipas një kalendari qëndron në sekretari gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët në faqen zyrtare uamd.edu.al kanë të afishuar kurrikulën e programit të studimit, dhe rregulloren apo statutin e UAMD. Cdo fillim viti organizohet ajo që njihet si java e orientimit të studentëve. Cdo department përgjegjës për programin e studimit prezanton lektorët e departamentit, programin e studimit, përgjegjësit e cdo programi studimi, detaje mbi rregulloren, dhe cdo udhëzim tjetër të nevojshëm për këdo që vjen për here të pare. Kurrikula e programit të studimit i jepet studentëve në vit të parë një kopje në dorë, por gjithashtu mund te gjendet dhe online.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në faqen zyrtare uamd.edu.al nën Menunë e programit të studimit, gjendet vizioni i programit të studimit, misioni, thirrje të herëpasherdhme në lidhje me aktivitetet gjithashtu kemi dhe kurrikulën e detajuar me kurse, semester dhe numrin e krediteve. Studentëve në vitin e parë ju përcaktohet një mentor me të cilin ata do të komunikojnë gjatë gjithë kohës në Universitet dhe do të mund ta pyesin për cdo gjë të paqartë me procesin e studimit
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Universiteti dhe zyra e karrierës në mënyrë të vazhdueshme publikojnë thirrje për mundësi punësimi për studentët aktualë dhe ata alumni. Karriera UAMD është një faqe në Facebook dhe Instagram që informon të gjithë të interesuarit mbi aktivitetet dhe mundësitë e punësimit. Gjithashtu dhe njësia kryesore e Teknologjisë së Informacionit në faqen e vet në Facebook lajmëron gjithë studentët specifik të fushës mbi mundësi punësimi. Takime të herëpashershme kryhen në institucion me studentët në lidhje me përgatitjen e tyre për tregun e punës.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët kanë akses në faqen zyrtare të UAMD ku i bëhet e ditur kalendari akademik për vitin përkatës si dhe orari i detajuar mbi semestrin. Gjithashtu ata kanë dhe platformën e vet ku regjistrohen për orarin dhe kanë informacionet përkatëse (PITAGORA). Sa herë që kemi ndryshime në sallë apo në orarin mësimor studentët përditësohen nëpërmjet platformës. Studentët gjithashtu në kohën e tyre të lire, brenda orarit zyrtar, dhe nëse laboratorët nuk janë të zënë, mund të bëjnë një kërkesë tek laboranti për përdorimin e laboratorit sipas nevojës (brenda qëllimeve mësimore). Gjithshu në orën e parë të mësimit studentët duhet të plotësojnë një listë me adresate tyre për të bërë të mundur krijimin e klasës në Google Classroom, ku student mund të informohet në kohë reale për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, ku mund të bëhet ngarkimi i detyrave, leksioneve, lajmërimeve, etj.
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e	Nëkurrikulën e programit të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike” nuk ka një lëndë të mirëfilltë të emetuar “Praktika profesionale”, por lënda “Riparim i pajisjeve elektronike” ka karakter të plotë praktik. Kjo lëndë zhvillohet kryesisht në laborator, të cilët janë pajisur me sisteme kompjuterike ose sisteme të ndryshme elektronike, me të cilët studentët mun të praktikohen në njohjen, përcaktimin e gjendjes, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të ndryshme elektronike. Lektorët mund të realizojnë aktivitete me karakter praktik në pika shërbimesh brenda programit mësimor.

në tregun e punës.	Kontakti me mentorët kryhet nëpërmjet postës digjitale dhe orareve të konsultimit. Aksesit në faqen e webit, aksesit në faqen zyrtare të UAMD dhe NJKTI në rrjetet sociale, por gjithashtu dhe aksesit në “klasën” e krijuar nga lektori lejon që studentët të informohen në kohë reale mbi aktivitetet me karakter praktik, mundësitë e punësimit duke i orientuar ata drejt nevojave të tregut të punës. Sistemi Pitagora i regjitrimit të studentëve i mban ata të informuar për çdo ndryshim gjatë kohës së realizimit të programit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4																													
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.																													
Kriteret	Vlerësimi																												
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria Mësimore, Kryesekretaria, drejtorja e IT janë përgjegjësit për ofrimin e një platforme që lejon aksesin e studentëve aktual dhe ruajtjen e informacionit. Ndërkohë që kryesekretaria ka raportin e vet elektronik të ecurisë së studentëve, të numrit të studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar. Zyra e alumni dhe e karrierës janë përgjegjëse për disponimin e informacionit mbi studentët alumni.																												
	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="5">SPECIALIST PAJISJESH ELEKTRONIKE</th> </tr> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Te regjistruar</th> <th>Te çregjistruar</th> <th>Te diplomuar</th> <th>Te transferuar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>41</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>52</td> <td>2</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>25</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>				SPECIALIST PAJISJESH ELEKTRONIKE					Viti akademik	Te regjistruar	Te çregjistruar	Te diplomuar	Te transferuar	2020-2021	41	2	1	0	2021-2022	52	2	0	0	2022-2023	25	0	0	0
SPECIALIST PAJISJESH ELEKTRONIKE																													
Viti akademik	Te regjistruar	Te çregjistruar	Te diplomuar	Te transferuar																									
2020-2021	41	2	1	0																									
2021-2022	52	2	0	0																									
2022-2023	25	0	0	0																									
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sipas politikave të sigurisë dhe ruajtjes së privatësisë, që disponon institucioni i arsimit të lartë kemi mbrojtjen e informacionit sensitive nga palët e paautorizuara. Platforma elektronike lejon aksesin vetëm për personat e autorizuar dhe kontrollon aksesin në të dhëna sensitive për persona të paautorizuar. (Studentët kanë akses vetëm tek notat e tyre, lektori ka akses vetëm tek lëndët e veta, sekretaria nuk ka akses të ndryshojë notat e kurseve. <i>(Evidenca 7_Rregullore e NJKTI_ Neni 7; Neni 69, pika 8)</i>																												
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e	Për mbarëvajtjen në menaxhimin e dokumentacionit dhe informacionit që lidhet me studentët institucioni realizon kontrole të rregullta vjetore mbi të gjitha njësitë përgjegjëse. Dokumentacioni dhe informacioni gjendet në formë fizike pranë sekretarisë mësimore, por edhe në sistemin online. Në sistemin Pitagora mund të verifikohet lehtësisht informacioni mbi ecurinë e studentëve mbi rezultatet e arritura nga ana e tyre.																												

tyre përkatëse.				
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Sektori i Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës, disponon të dhëna statistikore mbi notën mesatare në hyrje dhe në dalje për çdo student si dhe përqindjen e kalueshmërisë të cilët janë disa nga treguesit e cilësisë së studentëve në hyrje (nota mesatare me të cilën kanë konkurruar për të vazhduar ciklin tjetër të studimeve) dhe në dalje (nota mesatare që kanë përfunduar ciklin e studimeve). Këto të dhëna sigurohen nga sekretaritet mësimore të çdo Njësie Kryesore, duke qenë se këto të fundit kanë të dhëna sasiore mbi cilësinë e studentëve përmes regjistrimit elektronik me notat për çdo student. Sekretaritet ja përcjellin këtë informacion Sektorit të Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës dhe mbahet nga ky i fundit për efekt statistikor ose si informacion që u jepet të interesuarve për këto të dhëna. (Evidenca 43_Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas rregullores së UAMD, por dhe sipas akteve ligjore, student ka përfaqësinë e vet në vendimmarrje, (Në bord administrimi, në këshilla studentorë dhe në procese të ndryshme). Studenti i nënshtrohet një pyetësori për të vlerësuar lektorin, kursin dhe procesin e mësimit çdo semester. Gjithashtu studentët kanë lirinë të ndërtojnë strukturat e tyre që i lejon rregullorja e institucionit, këshillat studentorë. (Evidenca 6_Rregullore UAMD, neni 121, pika dh)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në përfundim të çdo viti akademik, për lektorët ndërtohet një raport vlerësimi nga ana e përgjegjësitë të njësisë bazë, si pjesë e proceseve të vlerësimit të brendshëm. Një nga pikat e raportit është dhe rezultatet e vlerësimit të studentëve nëpërmjet pyetësorit përkatës. Nga ana tjetër institucionin sipas rregullores përkatëse zhvillon zgjedhjet për kryetarët e këshillit sipas cdo fakulteti. Cdo student është i lire të zgjedh përfaqësuesin e vet. Studentët gjithashtu zënë 10% të votive për Drejtues të Njësive Kryesore dhe Rektor të Universitetit. (Evidenca 7_Rregullore e NJKTI, KREU VI, neni 87,pika c)
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe	Ndërtimi i kurrikulave krijohet duke u mbështetur jo vetëm në kurrikulat bashkëkohore ndërkombëtare, por dhe duke marr parasysh kriteret për transferimin e studentëve, nga një degë në tjetrën brenda njësisë kryesore dhe nga një program studimi në programe të tjera studimi jashtë universitetit (dhe anasjelltas). (Evidenca 6_Rregullore UAMD, neni 121, pika 6,b, Neni 61 Kurrikula pika

(Handwritten signatures and initials)

fokusimi, etj.	<p>1. 3; <i>Evidenca 7</i>_Neni 44 pika 1)</p> <p>Ngarkesa akademike e studentëve në programin e studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”. ka pasur vëmendjen e duhur gjatë hartimit të planit mësimor të këtij program. Ai është në përputhje me aktet nënligjore (jo më tepër se 25 orë në javë). Me kërkesë të studentit, njohja e krediteve nga studime të mëparshme meret në konsideratë nga komisioni i transferimeve, i cili përcakton përputhshmërinë e tyre me lëndët e ofruara në programin e studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”.</p> <p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit reflektohet nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve nga ana e tyre dh takimeve të hapura me ta.</p> <p>(<i>Evidenca 44</i>_Pyetësor Student UAMD; <i>Evidenca 45</i>_Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>1. Studenti jep mendimin e tij në pyetësorin që zhvillohet për lektorët në përfundim të çdo semestri. Një prej qëllimeve të pyetësorit është ti jap mundësinë studentit të shpreh mendimin e tij në lidhje me barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të kontrollit të dijeve nga ana e lektorit.</p> <p>2. Sipas <i>rregullores së UAMD (Neni 69 dhe 71) /NJKTI (Neni 56) /NjBTI</i> dhe programi studimit çdo student ka të drejtë të shikojë fletën e provimit dhe të ballafaqohet me mënyrën e korrigjimit të provimeve në kohën dhe sallën e përcaktuar nga lektori i lëndës. (Neni 69) Në orën pasardhëse të mësimit personeli akademik shpjegon provimet e ndërmjetme për studentët dhe bën ballafaqimin e rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të lektorit të kursit, për të marrë sqarimet e duhura. Në rastin e provimit përfundimtar lektori i kursit cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Lektori duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme. Në rast problemesh me sistemin lektori i kursit informon përgjegjësën e njesisë bazë. (pika 7)</p> <p>3. Sipas Nenit 71 të rregullores UAMD dhe 56 NjKTI, studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Dekanit të Njësia kryesoret të Teknologjisë së Informacionit jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve.</p> <p>(<i>Evidenca 6</i>_Rregullore e UAMD, <i>Evidenca 7</i>_Rregullore e NJKTI)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka ngritur në shërbim të tij, Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike e cila në përbërjen e saj ka Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Ky sektor është përgjegjës për shërbimin e informacionit dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët, por edhe me palë të tjera të interesuara.</p> <p>(Evidenca 43_Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, (Evidenca 46_Struktura organizative e UAMD; https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/administrata/)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Këshillimi dhe ndjekja e përparimit të studentëve si dhe asistimi i tyre për çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit, realizohen nga lektorët mentorues përmes procesit të mentorimit të studentëve dhe koordinatorit të degës.</p> <p>(Evidenca 22_Vendimi për përcaktimin e koordinatorëve të programeve të studimit)</p> <p>Institucioni ka ngritur në shërbim të tij, Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike e cila në përbërjen e saj ka Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p>Ky sektor është përgjegjës për shërbimin e informacionit dhe komunikimit të vazhdueshëm me studentët por edhe me palë të tjera të interesuara.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UAMD ka ngritur një structure, që ofron shërbimin e këshillimit të karrierës për studentët, e cila emërtohet Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Kjo qendër karriere u ofron studentëve këshillim karriere, me qëllim lehtësimin e qasjes së tyre në tregun e punës dhe konkretisht, përmes informimit në lidhje me atë sesi të shkruajnë CV, Letër Motivimi, si të kryejnë një intervistë të suksesshme, njoftimin e tyre mbi mundësi punësimi dhe për praktika profesionale.</p> <p>(Evidenca 43_Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës)</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës bën gjurmimin dhe ndjekjen e studentëve të diplomuar, mbledh të dhëna mbi punësimin e tyre dhe krijon Databazën Alumni me të dhënat mbi punëshmërinë. Databaza Alumni rifreskohet nga mbledhja e të dhënave pas dërgimit elektronikisht dhe plotësimit të formularit Alumni nga ish-studentët. Databaza i vihet në dispozicion organeve drejtuese të UAMD nëse kërkohet.</p> <p>(Evidenca 47_Bazë të dhënash mbi punësimin e studentëve të NJKTI)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional ne “Specialist Pajisjesh Elektronike”

RVB dhe analiza e standardeve të tij do të mbyllet me “Analizën përmbledhëse të RVB” sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat). Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit është Fakulteti më i në UAMD dhe synon të jetë një ndër njësitë përbërëse më elitare si pasojë e burimeve njerëzore që ka dhe fushave bashkëkohore të kërkimit shkencor në teknologji.

Pikat e forta dhe afirmime

- Program studimi unik në Institucionet Publike në Shqipëri dhe plotëson dijet teorike të marra gjatë zhvillimit të programit profesional të studimit “Specialist Pajisjesh Elektronike”;
- Ideim, organizim dhe administrim i programit në përputhje me standardet europiane;
- Programi i studimit dhe syllabuset e kurseve të përfshira në kurrikul plotësojnë standartet e kërkuara, gjë që tregohet në metodologjinë e mësimdhënies, informacionin dhe literaturën bashkëkohore të përdorur;
- Bashkëpunime me institucione arsimore vendase dhe Europiane me eksperiencë në fushën inxhinierimit dhe profesionalizmit;
- Përmirësimi i kurrikulës në mënyrë të vazhduar për të ecur në kohorencë me zhvillimet e fundit teknologjike;
- Mbështetja dhe ngritja e programit në përputhje me strategjinë e zhvillimit, misionit dhe vizionit të UAMD dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit si pjesë e tij;
- Infrastrukturë moderne e vënë në dispozicion të stafit dhe studentëve;
- Menaxhimi efektiv i programit përmes ndarjes së ngarkesës mësimore, cilësisë së mësimdhënies, vlerësimit të studentëve dhe pedagogëve, realizimi i projekteve praktike, etj;
- Vitaliteti i stafit akademik, profesionalizmi, mësimdhënia cilësore dhe interaktive siguron përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi;
- Klima pozitive e bashkëpunimit midis stafit akademik dhe studentëve ku respektimi i të drejtave të tyre është në qendër të politikave dhe strategjive të zhvillimit;
- Përkushtim i Njesisë Bazë për të ofruar një program serioz dhe konkurrues;
- Kërkesë në rritje për studime në programet profesionalee ndikuar edhe nga vendosja e kriterit skualifikues të mesatares së VKM për programet bachelor
- Fushat dhe specialitet e programit të studimit së bashku me infrastrukturën moderne, hapin rrugën për ndërtimin e një instrastrukture të duhur dhe bashkëkohore duke u bërë ndër të parët specialistë në këtë fushë.

Pika të dobta


- Numër i vogël studentësh;
- Studentë me notë mesatare të ulët;
- Përfshirja e kufizuar e studentëve në aktivitetet e Njesisë Bazë në fushën e elektronikës.

Rekomandime

- Zhvillimi më tej i kërkimit profesional në fushat më bashkëkohore të elektronikës
- Bashkëpunimi me universitet e tjera të huaja dhe të vendit;
- Rritja e bashkëpunimit të mëtejshëm me biznesin dhe sektorin e shërbimeve;
- Ofrimi i shërbimeve profesionale për palët e treta.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHËTËTJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Lista e dokumentacionit mbështetës të vetvlerësimit

Lista e mëposhtme është dokumentacion i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë; mundet që në një dokument mund të përmbliidhen disa nga të dhënat e kërkuara.

Në rastet kur dokumenti është ndryshuar totalisht ose pjesërisht, citimi i tij duhet të reflektojë edhe ndryshimet e bëra (ose të bashkëngjiten të dy dokumentet). Gjithashtu mund të përdoren evidenca të tjera që Institucioni ka në funksionin e tij.

Lista e dokumentave përmban **emërtimin e plotë të dokumentit** (psh statuti etj), ndërsa në Raport duhen cituar **edhe pjesët përkatëse të tij** (psh statuti i IAL, neni x, pika y).

Në rastin e mbështetjes / citimit në ligjet/aktet ligjore, këto dokumenta duhet të jenë pjesë e listës së mëposhtme (pjesërisht/ose plotësisht)

1. Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë që ofrojnë Programin; (Evidenca 6- Rregullore UMAD; Evidenca 7- Rregullore FTI)
2. Dosja e programit të studimit e plotësuar me të gjitha elementët e nevojshëm; (Evidenca 2_Urdhër për hapjen e programit profesional “Specilaist Pajisjesh Elektronike”; Evidenca 18_Plani mësimor për programin e studimit; Evidenca 35_CV e stafit Akademik)
3. Rregullore e programit të studimit; (Evidenca 23- Rregullore e programit të studimit)
4. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit; (Evidenca 9_Misioni dhe studimi i tregut të punës)
5. Strategjia e zhvillimit të programit; (Evidenca 4_Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025)
6. Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike e financiare; (Ligj_80-2015_22.07.2015 për arsimin e lartë, Neni 3)
7. Politika të burimeve njerëzore, politikat e punësimit, përfshirë rekrutimin dhe

përzgjedhjen; (Evidenca 48. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike DBNjJ)

8. Politika e zhvillimit të stafit akademik; (Evidenca 4_Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025)

9. Struktura organizative e IAL dhe programeve; (Evidenca 46. Struktura Organizative e UAMD)

10. Politika e jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentëve; (Evidenca 30. Rregullore Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DPMJ), Neni 16, fq 22)

11. Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie; (Evidenca 6-Rregullore UMAD, Neni 60, Evidenca 7- Rregullore FTI, Neni 43, dhe Rregullore NjBSC, Neni 6)

12. Politika të vlerësimit akademik të stafit e mësimdhënies; (Evidenca 17. Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 6)

13. Rregulloret për testimet e provimet, kriteret dhe procedurat e diplomimit etj; (Evidenca 6- Rregullore UMAD, Neni 69, Neni 70, Neni 72 dhe Neni 75; Evidenca 7- Nenet 52-56 dhe 59-63; Evidenca 23- Rregullore e programit të studimit, Neni 16 dhe KREU III)

14. Diplomat dhe suplementet e diplomave; (Evidenca 20- Suplementi i diplomës)

15. Procedurë dhe ankimimi për studentët; (Evidenca 6- Rregullore UAMD, Neni 71; Evidenca 7- Rregullore FTI, Neni 56);

16. Procedurë për mbështetjen, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit; (Evidenca 17- Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë NjBSC)

17. Procedura për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies; (Evidenca 17- Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë NjBSC)

18. Politika e pranimit të studentëve;(Evidenca 24- Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve; Evidenca 25- Vendim Senati për Kuotat)

19. Procedura e regjistrimit të studentëve, databaza e studentëve/regjistri; (Evidenca 7- Rregullore FTI, Neni 67, databaza e studentëve dhe regjistri janë sekretari por për arsye ruajtje privatësie nuk nxirren nga sekretaria)

20. Politika të mbështetjes, përkrahjes, etj. për studentët dhe struktura organizative të tyre; (Evidenca 6- Rregullore UAMD, Neni 115; Evidenca 7- Rregullore FTI, Neni 87, Evidenca 29- Kodi i Etikës UAMD, KREU III, Neni 17)

21. Veprimtaria kërkimore, monitorimi dhe rezultatet në nivel programi; (Evidenca 31- Përmbledhëse e formularit të vlerësimit kërkimor shkencor 2020-2022; Evidenca 32- Formular vetëvlerësimi; Evidencë 33- Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë)

22. Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programit; (Evidenca 30. Rregullore Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DPMJ) dhe Evidenca 14- Listë MoU)

Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit

Evidenca 1. Mendimi i Dekanit

Evidenca 2. Urdhër për hapjen e programit të studimit

Evidenca 3 Urdhër për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm

Evidenca 4. Strategjia kombetare e arsimit 2021-2026

Evidenca 5. Statuti i UAMD

Evidenca 6. Rregullore e UAMD

Evidenca 7. Rregullore e Njesisë Kryesore (Rregullore FTI)

Evidenca 8. Plani i zhvillimit strategjik të UAMD 2020-2025

Evidenca 9. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit

Evidenca 10. Personeli akademik i angazhuar në NJKTI

Evidenca 11. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD

Evidenca 12. Urdhër për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të cilësisë së Brendshme të UAMD

Evidenca 13. Marreshjet e nenshkuara per vitet 2021-2022

Evidenca 14. Listë MoU

Evidenca 15. Tabela e mobiliteteve per viteve akademike 2020-2021, 2021-2022

Evidenca 16. Ftesë, axhenda dhe libri i abstrakteve të Konferencës studentore

Evidenca 17. Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të Cilësisë

Evidenca 18. Plani mësimor i programit të studimit

Evidenca 19. Dokumentacioni i hapjes të programit të studimit

Evidenca 20. Suplementi i diplomës

Evidenca 21. Syllabuset e lëndëve

Evidenca 22. Vendimi për përcaktimin e koordinatorëve të programeve të studimit

Evidenca 23. Rregullore mësimore për programin profesional SPE

Evidenca 24. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve

Evidenca 25. Vendim Dekanati për Kuotat

Evidenca 26. Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e sistemit të vlerësimit të studentëve)

Evidenca 27. Për miratimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit të UAMD

Evidenca 28. VKM: Për elementet e programit të studimit të ofruara nga IAL

- Evidenca 29. Kodi i etikës
- Evidenca 30. Rregullore Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DPMJ)
- Evidenca 31. Përmbledhëse e formularit të vlerësimit kërkimor shkencor 2020-2022
- Evidenca 32. Formular vetëvlerësimi
- Evidencë 33. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë
- Evidenca 34. Memo mbi rikontrollin e provimeve
- Evidenca 35. CV stafi akademik i NJBTI
- Evidenca 36. Stafi ndihmës akademik per programin profesional SPE
- Evidenca 37. Analize vjetore e Njesisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit
- Evidenca 38. Ngarkesa e lektorëve të NJBTI
- Evidenca 39. Kontratat e punësimit të stafit të NJBTI
- Evidenca 40. Tabela e kualifikimeve të stafit të NJBTI
- Evidenca 41. Foto nga laboratorët
- Evidenca 42. Urdhër për funksionimin e bibliotekës në fundjavë
- Evidenca 43. Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës
- Evidenca 44. Pyetësor Student UAMD
- Evidenca 45. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)
- Evidenca 46. Struktura Organizative e UAMD
- Evidenca 47. Bazë të dhënash mbi punësimin e studentëve të NJKTI
- Evidenca 48. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike
- Evidenca 49. Rregullorja e bibliotekës
- Evidenca 50. Programet e studimit të ofruara në NJKTI
- Evidenca 51. Arsyet për të zgjedhur UAMD
- Evidenca 52. Materiale promovuese UAMD

